



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Agjencia e Statistikave të Kosovës

Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare 2021

Prill, 2020

Prishtinë

PËRMBAJTJA

Faqe

| | |
|---|-----------|
| LISTA E SHKURTESAVE | 3 |
| 1. PËRMBLEDHJA E OBJEKTIVAVE..... | 5 |
| 2. STRUKTURA E PVSZ 2021..... | 8 |
| 3. PRODHIMI STATISTIKOR..... | 9 |
| 4. VLERËSIMI I PERFORMANCËS..... | 11 |
| 4.1. Produktiviteti dhe efikasiteti | 13 |
| 4.2. Matja e prodhimit statistikor..... | 17 |
| 4.3. Cilësia | 18 |
| 4.4. Korniza e planifikimit | 19 |
| 4.4.1. Instrumentet e planifikimit..... | 20 |
| 4.4.2. Riorganizimi | 22 |
| 4.5. Kënaqshmëria e përdoruesve..... | 22 |
| 4.6. Përmbledhja e vlerësimit të performancës..... | 22 |
| 5. PLANI I VEPRIMIT VJETOR 2021..... | 25 |
| 5.1. Prioritetet strategjike..... | 25 |
| 5.2. Tabela përmbledhëse e zhvillimit organizativ më 2021..... | 25 |
| 5.3. Tabela përmbledhëse në zhvillimin e fushave statistikore në vitin 2021..... | 28 |
| 5.4. Përpunimi i Statistikave të Veçanta | 35 |
| 6. BUXHETI DHE PASQYRAT E PRODHIMIT | 36 |
| 7. PLANI I AKTIVITETEVE KRYESORE | 40 |
| 7.1. Bruto Produkti Vendor (BPV)..... | 40 |
| 7.2. Llogaritë Qeveritare dhe Ekonomia e Pavrojtuar | 41 |
| 7.3. Statistikat e Biznesit | 42 |
| 7.4. Çmimet..... | 43 |
| 7.5. Anketa e Ekonomive Bujqësore - Anketa e Kulturave Bujqësore Bimore edhe e Blegtorisë | 44 |
| 7.6. Statistikat Agromonetare | 44 |
| 7.7. Çmimet dhe Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Inputeve në Bujqësi..... | 44 |
| 7.8. Statistikat e Mjedisit- Anketa e Mbeturinave Industriale..... | 45 |
| 7.9. Anketa e Fuqisë Punëtore | 46 |
| 7.10. Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (SILC)..... | 46 |
| 7.11. Anketa mbi përdorimin e Teknologjisë informative dhe Komunikimit (TIK)..... | 47 |
| 7.12. Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2020 | 48 |
| 7.13. Aktivitetet kryesore të planifikimit dhe koordinimit..... | 49 |
| 7.14. Mbledhja e të dhënave | 50 |
| 7.15. Aktivitetet kryesore administrative | 50 |

LISTA E SHKURTESAVE

| | |
|--------|--|
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| AAKJ | Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës |
| ABEF | Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare |
| AEB | Anketa e Ekonomive Bujqësore |
| AFP | Anketa e Fuqisë Punëtore |
| AKP | Anketa e Kënaqshmërisë së përdoruesve |
| AKS | Anketa e Kënaqshmërisë së Stafit të ASK-së |
| ASB | Anketa Strukturore e Biznesit |
| AT | Asistencë Teknike |
| BB | Banka Botërore |
| BE | Bashkimi Evropian |
| BiP | Bilanci i Pagesave |
| BPV | Bruto Produkti Vendor |
| BQK | Banka Qendrore e Kosovës |
| DA | Departamenti i Administratës |
| DSBM | Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit |
| DSELLK | Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare |
| DMTI | Departamenti i Metodologjisë dhe TI-së |
| DPPKK | Departamenti i Politikave, Planifikimit, Komunikimit dhe Koordinimit |
| DRA | Departamenti i Anketimeve dhe Regjistrimeve |
| DSE | Departamenti i Statistikave Ekonomike |
| DLLK | Departamenti i Llogarive Kombëtare |
| DSS | Departamenti i Statistikave Sociale |
| ERA | Programi për Reforma në Ekonomi |
| FTË | Fondacioni për Trajnime Evropiane |
| FMN | Fondi Monetar Ndërkombëtar |
| GIS | Sistemi Gjeografik i Kosovës |
| IÇIMP | Indeksi i Çmimeve të Importit |
| IHÇK | Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit |
| IÇK | Indeksi i Çmimeve të Konsumit |
| IÇP | Indeksi i Çmimeve të Prodhimit |
| IKN | Indeksi i Kostos së Ndërtimit |
| IPA | Instrumenti i Para-Aderimit |
| ILO | Organizata Ndërkombëtare e Punës |
| KVP | Korniza e Vlerësimit të Performancës |
| KB | Kombet e Bashkuara |
| KASh | Korniza e Shpenzimeve Afat-Mesme |
| LIEB | Llogaritë Ekonomike për Bujqësi |
| LLK | Llogaritë Kombëtare |
| LLQ | Llogaritë Qeveritare |
| MeM | Memorandum Mirëkuptimi |
| NACE | Nomenklatura e Aktiviteteve në Komunitetin Evropian |
| OE | Operatori ekonomik |
| PIN | Statistika në Pozitën e Investimeve Ndërkombëtare |
| PKSZ | Programi Kryesor i Statistikave Zyrtare |
| PLAN | Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim |
| PSZ | Programi i Statistikave Zyrtare |

| | |
|--------|---|
| PVSZ | Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare |
| PZSZ | Programi i Zgjeruar i Statistikave Zyrtare |
| SASh | Statistikat Afat-Shkurta |
| SMIA | Sistemi Informativ për Menaxhimin e Arsimit |
| SE | EUROSTAT |
| SELI | Sistemi Evropian i Llogarive |
| SES | Sistemi Evropian i Statistikave |
| SCB | Statistikat e Suedisë |
| Sida | Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar |
| SLLK | Sistemi i Llogarive Kombëtare |
| TIK | Teknologjia informative e komunikimit |
| TFSH | Tabelat e Furnizimit dhe Shfrytëzimit |
| TI | Teknologjia Informativë |
| TIMD | Departamenti i Teknologjisë Informativë, Metodologjisë dhe Diseminimit/Shpërndarjes |
| TIK | Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit |
| UNDP | Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara |
| UNFPA | Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara |
| UNICEF | Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara |

1. PËRMBLEDHJA E OBJEKTIVAVE

Në bazë të Ligjit mbi statistikat zyrtare, Plani i punës për vitin pasues përgatitet dhe duhet të dërgohet në Qeveri për aprovim jo më vonë se 31 Maj të vitit aktual. Identifikimi dhe vendosja e prioriteteve sipas nevojave të shfrytëzuesve për të dhëna zyrtare, janë bosht i Planit të Punës për vitin 2021.

Përmes këtij Plani të Punës synohet realizimi i objektivave të definuara nga Programi i Statistikave Zyrtare 2018-2022, bazuar në resurset njerëzore dhe financiare në dispozicion. Objektivi kryesor i ASK-së është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm statistikor, zgjerimi i prodhimit me hulumtime të reja, si dhe përmirësimin e cilësisë së statistikave zyrtare, në përputhje me metodologjinë ndërkombëtare (Eurostat). Duke u udhëhequr nga parimet e Kodit të Praktikës evropiane (CoP), ASK-ja synon të ofroj të dhëna statistikore: objektive, të paanshme, cilësore, të sakta, të besueshme, në kohë dhe relevante, që i përmbushin nevojat e të gjithë shfrytëzuesve.

Përveç përmirësimit të cilësisë së prodhimit statistikor, ASK-ja synon shkurtimin e afateve kohore në procesin e prodhimit, me qëllim të ofrimit të të dhënave zyrtare statistikore tek shfrytëzuesit në kohën më të shkurtër optimale të mundshme. Në aspektin afatgjatë (viti 2022) ky objektivi (shkurtimi i afateve kohore) synon arritjen në shkallën prej 10% më shumë shkurtim në krahasim me pragun e fillimit të zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare, gjegjësisht fundi i vitit 2017.

Përafrimi me Sistemin Evropian të Statistikave mbetet objektivë e vazhdueshme e ASK-së, ku përveç metodologjisë statistikore dhe rregullativës përkatëse, përafrimi i kornizës ligjore me ACQUIS vazhdon të mbetet objektivë edhe gjatë periudhës vijuese, duke përafruar parimet e njëjta të qeverisjes me ato të vendeve evropiane.

Përveç tjerash në tërësinë e tij, Plani i Punës përfshinë edhe prioritetet të cilat ndërlidhen me strategji dhe plane në nivel vendi për fusha të veçanta të cilat karakterizohen me ndërveprim qoftë në nivel ndërinstitucional qoftë atë ndërkombëtar. Procesi i integrimi evropiane, si strategji kombëtare, përfshin edhe Kapitullin e 18, Statistikat. Nga ky proces përveç aspektit afatmesëm janë të përfshira edhe prioritetet në aspektin afatshkurtër. Këto prioritete janë identifikuar nga viti në vit, përmes ndërveprimit BE-Kosovë dhe anasjelltas, me qëllimin e ngritjes së prodhimit dhe rritjes së cilësisë së statistikave zyrtare.

ASK, përveç prioriteteve që dalin nga rishikimi i PKZMSA, 2020-2024, ka përfshirë edhe prioritetet që dalin nga Plani Vjetor i Punës së Qeverisë 2021 (PVQ, ndër më kryesorët Regjistrimi i Popullsisë, Llogaritë Kombëtare, Statistikat Ekonomike, etj), Programin për Reforma në Ekonomi (PRE), qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 (SDGs 2030), si dhe Rekomandimet nga vlerësimi i Sistemit Statistikor të Kosovës përmes qasjes "Peer Review".

Plani Vjetor 2021 synon realizimin e objektivave, përmes shfrytëzimit më të mirë të burimeve humane dhe financiare dhe duke rritur efikasitetin organizativ, të rritet produktiviteti statistikor, cilësia, të fuqizohet Sistemi Statistikor i Kosovës, si dhe të arrihet përmbushja e kërkesave të shfrytëzuesve me të dhëna zyrtare të prodhuara sipas standardeve të BE-së.

Shikuar nga perspektiva e planifikimit dhe e monitorimit, për secilin vit brenda këtij Programi janë përcaktuar objektivat përkatëse, bazuar në kërkesat e brendshme dhe ndërkombëtare. Andaj, në këtë drejtim në fund të vitit 2017, është bërë matje e të arriturave në Programin e parë 5 vjeçar 2013-2017, e cila ka shërbyer si pikë referente për caktimin e objektivave 2018-2022. Qasja në hartimin e Planit Vjetor të Punës është e ndërtuar mbi bazën e KVP, duke vlerësuar të arriturat e vitit paraprak, analizimin e gjendjes egzistuese dhe caktimi i prioriteteve për vitin vijues.

Me procesin e planifikimit është i ndërlidhur edhe procesi i monitorimit përmes sistemit të SIPK- ut. Nga ajo që është thënë më lartë, ASK ja, gjatë vitit 2021 në nivel institucional gjegjësisht sektorial, synon:

- Rritjen e numrit të hulumtimeve (anketave) të reja statistikore;
- Përmirësimin e cilësisë së produkteve ekzistuese statistikore;
- Rritjen e nivelit të përputhshmërisë me standardet e BE-së;
- Zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale teknike të ASK-së;
- Fuqizimin e rolit koordinues të ASK-së në Sistemin Statistikor të Kosovës;
- Rritjen e numrit të raporteve të kualitetit;
- Modernizimin e qasjes në mbledhjen e të dhënave.

Në nivel sektorial, gjegjësisht prodhimin e statistikave sektoriale, prioritetet e PVSZ 2021, janë të listuara si në vijim:

Në kuadër të Kornizës së Burimeve Ekzistuese janë:

1. Llogaritë Kombëtare (PKSZ¹),
2. Statistikat e Biznesit,
3. Çmimet,
4. Tregtia e Jashtme,
5. Anketa e Ekonomive Bujqësore,
6. Anketa e Mbeturinave Industriale;
7. Anketa e Mbeturinave Komunale;
8. Çmimet dhe Indeksi i Çmimeve në Bujqësi;
9. Llogaritë Ekonomike për Bujqësi;
10. Vlerësimi Vjetor i Popullsisë;
11. Anketa e Fuqisë Punëtore,(AFP);
12. Statistikat e Lindjeve;
13. Statistikat e Vdekjeve;
14. Statistikat e Kurorëzimeve;
15. Statistikat e Shkurorëzimeve;
16. Statistikat mbi Shkaqet e Vdekjeve, (çdo dy vjet);
17. Gratë dhe Burrat në Kosovë, (çdo dy vjet);
18. Statistikat e Mirëqenies Sociale;
19. Niveli i Pagave;
20. Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës, (SILC);
21. Anketa e Buxhetit dhe Ekonomive Familjare, (ABF);
22. Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit në Ekonomitë Familjare, (TIK);
23. Statistikat e Arsimit

24. Statistikat e Jurisprudencës për Persona të Mitur;
25. Statistikat e Jurisprudencës për Persona Madhor;
26. Statistikat e Shëndetësisë;
27. Statistikat e Kulturës;
28. Bilanci i Energjisë;
29. Statistikat e Eficiencës së Energjisë;
30. Llogarite Qeveritare;
31. Ekonomia e Pavrojtuar;
32. Statistikat e Prodhimit Industrial;
33. Statistikat e Investimeve;
34. Statistikat Afatshkurtera të Shërbimeve.

Jashtë Kornizës së Burimeve Ekzistuese:

1. Matja e Ekonomisë së Pavrojtuar sipas Aktiviteteve;
2. Anketa e Kulturave Bujqësore Bimore;
3. Anketa e Blegtorisë;
4. Statistikat e Pylltarisë;
5. Parashikimet për Llogaritë Ekonomike në Bujqësi;
6. Statistikat e Pilot-Anketa mbi Ndërtimet dhe Demolimet;
7. Regjistrimi i Popullsisë

Objektivat e lartcekura janë prioritetet për vitin, 2021. Objektivat e listuara jashtë burimeve ekzistuese realizohen në varësi të sigurimit të burimeve të nevojshme buxhetore (njerëzore dhe financiare).

¹ Programi Kryesor i Statistikave Zyrtare (PKSZ) definohet përmes PSZ 2018-2022 me minimumin e kërkesave për prodhimin e statistikave, për t'i mbuluar nevojat bazë për vendimmarrje të Qeverisë. Nevojat e tjera për Statistika, të shprehura nga përdoruesit kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si dhe nga Programi Statistikor i BE-së, do të ketë përparësi në Programin e Zgjeruar (PZSZ). Shih në vijim pjesën e pasqyrës së publikimit 3.2.

2. STRUKTURA E PVSZ 2021

Qasja e përgjithshme në hartimin e Planit të Punës mbështetet në një cikël analizash, duke filluar me vlerësimin e performancës në vitin paraprak, analizën e gjendjes në vitin aktual dhe planifikimin e së ardhmes, mbështetur në resurset e disponueshme. Prandaj, përmbajtja e Planit Vjetor 2021, është e bazuar në tri shtylla kryesore:

1. Vlerësimin e Performancës;
2. Prioritetet Strategjike;
3. Pjesën e Buxhetit dhe të aktiviteteve kryesore.

Të tri shtyllat e lartpërmendura janë të bazuara në procese argumentuese, sipas Ciklit të Planifikimit.

- a) Vlerësimi i Performancës, bëhen përmes matjes dhe analizës së të arriturave në vitin paraprak;
- b) Prioritetet Strategjike, disa prej tyre kanë shtrirje kohore përtej vitit referues, megjithatë, caktimi dhe zbatimi i tyre bëhet në përputhje me dinamikën kohore. (shih kapitulli 4.1.3 dhe 4.2 PSZ 2018-2022);
- c) Pjesa e Buxhetit dhe e aktiviteteve kryesore, përfshinë burimet financiare dhe aktivitetet kryesore të planifikuara gjatë një viti në përputhje me resurset në dispozicion.

Pjesë përbërëse e rëndësishme është edhe KVP-ja, zbatimi i së cilës mundëson matjen e progresit për 8 indikatorët kyç, 4 nga SIPK-u, pjesa tjetër nga burime tjera horizontale.

3. PRODHIMI STATISTIKOR

Ekzistenca institucionale e ASK-së, është e ndërlidhur në mënyrë eksplicite me prodhimin, gjegjësisht me plotësimin e kërkesave të shfrytëzuesve me të dhëna zyrtare statistikore. Prandaj, rritja e prodhimit statistikor apo zgjerimi aktiviteteve kërkimore me hulumtime të reja statistikore, paraqet një nga objektivat e PSZ dhe synimet kryesore të Planit Vjetor të punës 2021. Aplikimi i dinamikës me një normë të prodhimit 3-5% nga viti në vit, e bën të realizueshëm objektivin kryesor me normën prej 20% me hulumtime të reja statistikore, deri në fund të vitit 2022.

Procesi i planifikimit është i ndërlidhur me procesin e monitorimit, prandaj për këtë qëllim është bërë prerja e gjendjes së prodhimit në fund të zbatueshmërisë së PSZ 2013-2017. Në fund të vitit 2017, gjegjësisht me përfundimin Programit të parë të Statistikave Zyrtare, ASK, ka arritur të prodhojë 60 produkte statistikore dhe 120 publikime statistikore. Fondi i Prodhimit Statistikor është i strukturuar sipas statistikave sektoriale përfshirë prodhimet në baza dy vjetore (frekuenca e publikimit në çdo 2 vjet), vjetore, tremujore dhe ato mujore.

Në baza dy vjeçare – publikohen: Gratë dhe Burrat në Kosovë, Shkaqet e Vdekjeve në Kosovë, Statistikat e Ujërave në Kosovë dhe Disa Fakte mbi Mjedisin.

Në baza vjetore - publikohen: Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Prodhimit dhe Shpenzimeve, Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Statistikat e Tregtisë së Jashtme, Llogaritë Qeveritare, Rezultatet e Anketës së PRODCOM- it, Bilanci i Energjisë, Statistikat e Turizmit, Rezultatet e Anketës mbi Përdorimin e Teknologjisë Informativë dhe të Komunikimit (TIK) në Ndermarrje, Statistikat e Investimeve në Ndermarrje, Rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore, Llogaritë Ekonomike në Bujqësi, Indeksi i Çmimeve në Bujqësi, Rezultatet e Anketës së Mbeturinave Industriale, Rezultatet e Anketës së Mbeturinave Komunale, Rezultatet e Anketës së Mbeturinave të Trajtuara, Statistikat e Ajrit (GHGE), Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore, Niveli i Pagave në Kosovë, Rezultatet e Anketës mbi Përdorimin e Teknologjisë Informativë dhe të Komunikimit (TIK) në Sektorin e Eknomive Familjare, Rezultatet e Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (SILC), Statistikat për Shëndetësinë, Statistikat për Arsimin, Statistikat për Mirëqenien Sociale, Jurisprudencën, për Kulturën, Statistikat e Lindjeve, Vdekjeve, Kurorëzimeve, Shkurorëzimeve si dhe Vlerësimi i Popullsisë. Gjithashtu nga publikimet me karakter të përgjithshëm në baza vjetore publikohen edhe Vjetari Statistikor, Kalendari i Publikimeve, Kosova në Shifra, Katalogu i Publikimeve, etj.

Në baza tremujore - publikohen: Bruto Produktin Vendor (BPV) me Qasjen e Prodhimit dhe Shpenzimeve, Llogaritë Qeveritare, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit, Indeksi i Çmimeve të Importit, Indeksi i Kostos së Ndërtimit, Bilanci i Energjisë, Statistikat e Hotelarisë, Statistikat e Transportit, Statistikat e Tregtisë me Pakicë, Statistikat e Industrisë, Repertori Statistikor i Ndërmarrjeve, Statistikat e Shërbimeve, Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Inputeve në Bujqësi, Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore, Statistikat e Mirëqenies Sociale dhe Buletini Tremujor.

Ndërsa në baza mujore - publikohen: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) dhe Statistikat e Tregtisë së Jashtme.

ASK-ja, po ashtu mirëmban regjistrat statistikorë vijues:

- Regjistrin e Popullsisë;
- Regjistrin e Ekonomive Familjare;
- Regjistrin e Banesave dhe Ndërtesave;
- Regjistrin Statistikor të Bizneseve;
- Regjistrin e Qarqeve Regjistruese;
- Regjistrin e Ekonomive Bujqësore;
- Regjistra dhe Baza të tjera të të dhënave.

Disa prodhime realizohen në bashkëpunim me Agjenci të tjera publike.

Sipas Ligjit të Statistikave Zyrtare në Kosovë, ASK-ja duhet të zhvillojë statistika bazuar në standardet e BE-së. Qëllimi i prodhimit të statistikave është përmbushja e nevojave të shfrytëzuesve me të dhëna statistikore sipas standardeve të BE-së, si në prodhimin, ashtu edhe në cilësinë e statistikave. Raportet e publikuara vlerësuese për ASK-në nga Komisioni Evropian (Eurostat) dhe organizata tjera ndërkombëtare, rekomandojnë rritjen e sasisë dhe cilësisë së prodhimeve statistikore. Në këtë kontekst, ASK-ja ka bashkëpunuar ngushtë dhe do të vazhdojë të bashkëpunojë me partnerët ndërkombëtarë, me qëllim të rritjes së cilësisë së statistikave zyrtare, sipas standardeve ndërkombëtare në fushën e Statistikave Zyrtare.

4. VLERËSIMI I PERFORMANCËS

Monitorimi i zhvillimit të proceseve statistikore dhe raportimi paraqet një ndër proceset e rëndësishme në ciklin menaxherial të ASK-së. Përmes sistemit të SIPK-ut dhe njësisve tjera horizontale, ASK-ja, siguron informacion mbi performancën vjetore paraprake. Ky proces monitorimi realizohet përmes të ashtuquajturës Kornizë e Vlerësimit të Performancës (KVP). Monitorimi dhe raportimi për performancën në nivel të ASK, dhe fushave përkatëse sektoriale statistikore, bëhet në baza vjetore, por sipas nevojës edhe në afate më të shkurtëra kohore. ASK-ja këtë qasje (monitorimi përmes KVP) ka filluar ta zbatojë që nga viti 2013 dhe vazhdon ta zbatoj edhe më tutje. Si rezultat kemi të dhënat e bazuara në KVP, me burim të dhënash nga procesi i SIPK-ut dhe njësi tjera horizontale. Në vazhdim do të paraqiten treguesit e performancës, duke përshkruar statusin e tyre, gjegjësisht, gjendjen aktuale si dhe synimi për periudhën afatgjatë (5 vjeçare), gjegjësisht në fund të vitit 2022.

Pasqyrat në vijim ilustrojnë statusin e tetë (8) treguesve të KVP-së:

| Treguesit e rezultuar | Statusi 2019/2020 | Synimi për 2022 |
|--|--|---|
| 1 Numri i produkteve | Në fund të vitit 2019 janë prodhuar 61 produkte statistikore dhe 123 publikime statistikore. Gjate vitit 2020/2021 është planifikuar rritje rreth 4%. | 20% rritje (72) 20% rritje (144) |
| 2 Gjithsej numri i variablave | Për t'u mbledhur/grumbulluar nga përshkrimet e produkteve. | Në çdo kohë të mundshme listimi i variablave statistikore |
| 3 Gjithsej numri i treguesve kryesorë (BE- Lista e treguesve kyç statistikorë për vendet candidate). | Në fund të vitit 2019, nga 115 indikatorë, ASK është përfshirë me 79 tregues në publikimin "Key figures for enlargement countries edition 2019". Kjo rritje është planifikuar me 4% proporcionalisht për vitin vijues". | 20% rritje (90). |
| Treguesit e rezultuar | Statusi 2019/2020 | Synimi për 2022 |
| 4 Ditë pune-për njeri/produkt. | Numri mesatar i ditë-pune/produkt në fund të vitit 2019 për 61 produkte dhe 123 raporte statistikore ishte 107.3 respektivisht 53.2 ditë/produkt respektivisht publikim statistikor. Në total 6547 ditë pune. (të krahasueshme 118/113). Planifikohet rënie me 2% për vitin 2020 dhe 2021. | 10% reduktim (6247). |
| 5 Kalendari kohor, nga fundi i periudhës referuese deri në publikim/produkt. | Koha prodhuese në fund të vitit 2019 për 61 produktet ishte 173 ditë/produkt respektivisht 86 ditë/publikim statistikor (11369) . Planifikohet rënie me 2% për vitin 2020 dhe 2021. | 10% reduktim (9886) |
| 6 Shkalla e publikimeve në kohë . | Nga gjithsej, 123 publikime statistikore të prodhuara në fund të vitit 2019, prej tyre 116 respektivisht 94% janë publikuar në kohë. Planifikohet norma në 100%. | 100 % publikimeve në kohë. |
| 7 Seritë kohore të publikuara. | Në fund të vitit 2019, të gjitha publikimet statistikore janë publikuar në seri kohore (100%). Kurse prej produkteve statistikore kryesisht hulumtime të reja janë në proces të ndërtimit të serive kohore. | Seritë kohore të publikohen kurdo që është e mundshme. |
| 8 Vlerësimi i gabimit në mostër | Gjatë viteve 2018 dhe 2019 është bërë llogaritja e vlerësimit të gabimeve në mostër për AFP-në, TIK, AEB, SILC dhe ASN. | Vlerësimi i gabimit në mostër për të gjitha produktet deri në vitin 2022. |

Përmbledhje ekzekutive 2013-2017, 2018-2019 dhe objektiv 2022

| Treguesit | Përfunduar (40) | | Ndryshimi | Përfunduar (40) | | Plan | | Objektivi | %(+/-) |
|--|-----------------|---------|-----------|-----------------|---------|---------|---------|-----------|--------|
| 1 | 2 | | | 3 | | 4 | | 5 | 6 |
| Vitet | 2013 | 2017 | % | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | |
| T1.Produkte statistikore | 40 | 60 | +50 | 61 | 61 | 67 | 70 | 72 | +20% |
| T1a.Publikime statistikore | 93 | 120 | +29 | 118 | 123 | 134 | 139 | 144 | +20% |
| T4. Ditë pune për produkt (total) | 5877 | 5522 | -6 | 5341 | 4905 | 6534 | 6395 | 6256 | |
| T4a. Ditë pune për produkt (mesatarisht) | 147 | 138 | -6 | 134 | 123 | 109 | 107 | 104 | -10% |
| T5. Koha prodhuese (total) | 6211 | 5849 | -5.8 | 6319 | 5020 | 10325 | 10105 | 9886 | |
| T5a. Koha prodhuese (mesatarisht) | 155 | 146 | -5.8 | 158 | 126 | 172 | 168 | 165 | |
| T6. Norma e publikimeve në kohë | 56/93 | 119/120 | n/a | 114/118 | 115/123 | 133/134 | 138/139 | 144/144 | -10% |
| | 60% | 99% | +39 | 97 | 94 | 99 | 99 | 100 | |

(Burimi: ASK, të dhënat nga SIPK-u, Matja e performancës për periudhën 2013-2017, është bërë me 40 produkte edhe pse numri i produkteve në fund të vitit 2017, ishte 60. Kjo për shkak se baza startuese ishte 40 produkte në vitin 2013. Po ashtu matja e performancës për vitin 2018-2019, ka vazhduar të bëhet mbi bazën e 40 produkteve me qëllim të krahasueshmërisë së tyre nga viti në vit edhe pse në vitin 2019 ishin të prodhuara 61 produkte statistikore. Performanca deri në fund të zbatimit të PSZ 2018-2022 vazhdon mbi bazën e 40 produkteve, nëse në ndërkohë nuk vendose ndryshe.

Pjesa e analizës në kolonën Nr:3, për treguesit T4, T4a, T5 dhe T5a është bërë mbi bazën e 40 produkteve të krahasueshme ndërsa treguesit T1, T1a dhe T6 mbi bazën e 58 produkteve të krahasueshme sipas bazës së shënimeve në SIPK, për vitet 2018-2019.

Andaj, nga të dhënat e prezentuara në tabelë, shihet se efikasiteti organizativ ka shfaqur performancë pozitive (rritur) në të dy qasjet, qofte në rritje të produktivitetit qoftë në rënie të numrit të ditëve për produkt dhe kohës prodhuese.

Planifikimi për vitin 2020 si dhe atë 2021, është bërë mbi bazën e 60 produkteve (2017) me rastin e përfundimit të Programit të parë 5 vjeçar 2013-2017 dhe fillimin e zbatimit të Programit të dytë 2018-2023 në bazë të objektivave të vendosura në Programin Strategjik për Statistika Zyrtare. Qasja në vlerësimin e performancës është gjendja e vitit paraprak (2019), analiza e vitit aktual (2020) dhe planifikimi për vitin 2021, në tabelë janë paraqitur edhe të dhënat krahasuese për PSZ 2013-2017, gjegjësisht krahasimi i gjendjes në fund të zbatimit të Programit me gjendjen në fillim të zbatimit të Programit të parë 5 vjeçar.

Një nga qëllimet e ASK së është ofrimi i të dhënave statistikore zyrtare tek përdoruesi në kohë sa më të shkurtër (në tabelle koha prodhuese në vitin 2019 për produktet e krahasueshme prej 40, është shkurtuar në total prej 1299 ditë apo (-20.6%) në krahasim me vitin 2018) apo mesatarisht 32.5 ditë për secilin produkt statistikor. Në të dy treguesit, kjo është arritur duke rritur efikasitetin dhe efektivitetin në ASK (efikasiteti organizativ dhe prodhues).

Plani për vitin 2021 është i ndërtuar mbi parimet dhe objektivat e Programit 2018-2022, kështu që nga viti në vit parashihet një normë osciluese në rritjen e prodhimit në shkallen prej 4% dhe shkurtim të kohës për produkt në shkallen prej -2% (efikasiteti organizativ dhe prodhues).

Në këtë kontekst PSZ 2018-2022, operacionalizohet përmes Planit Vjetor të Punës dhe monitorohet me Raportin Vjetor të Punës, duke aplikuar KVP-në. Në këtë kontekst KVP-ja, në PSZ 2018-2022, do të vazhdojë të ketë në fokus aspekte (pika) të rëndësishme të vlerësimit vjetor si:

- a) Fuqizimin e mëtejshëm të planifikimit në ASK;
- b) Matjen e efikasitet prodhues;
- c) Monitorimin e përafrimit me BE-në;
- d) Matjen e kënaqshmërisë së përdoruesve;
- e) Rritjen e imazhit dhe besueshmërinë për ASK-në;
- f) Përshkrimin e metadatave për produkte statistikore.

Disa nga aspektet (pikat) nga a-d janë të shtrira në kuadër të KVP si p.sh, aspekti prodhues matet me treguesin 1, aspekti i monitorimit, matet me treguesin 3, etj. Ndërsa aspektet tjera edhe pse janë jashtë sistemit të SIPK-ut (d-f) vazhdojnë të mbeten prioritet i ASK-së, dhe matja e tyre bëhet përmes formave tjera, si takime të ndryshme më përdorues, Anketa e Kënaqshmërisë së Përdoruesve, Sistemi i Metadatave, etj.


4.1. Produktiviteti dhe efikasiteti

Një nga shtyllat e PSZ 2018-2022, është rritja e produktivitetit dhe efikasitetit prodhues për statistika zyrtare, përmes racionalizimit të resurseve humane dhe financiare. Synim mbetet shkurtimi i ditëve-pune për produkt, shkurtimi i kohës prodhuese, indikatorët 4 dhe 6 (efikasiteti prodhues) ndërsa, rritja e numrit të publikimeve, monitorimi i përfshirjes në publikimet e Eurostatit për vendet zgjerimit dhe normës së publikimeve në kohë, vazhdon të bëhet përmes treguesve 1, 3, 5 dhe 6. Në vazhdim janë paraqitur treguesit e Kornizës Vlerësuese të Performancës.

KVP Treguesi 1 – Numri i produkteve

Numri i produkteve statistikore në Planin e Punës gjatë vitit 2019 ishte, 61 sosh, të cilat kanë një frekuencë publikimi nga ato dy vjeqare deri tek ato në baza mujore, Në fund të vitit 2019 janë prodhuar 61 produkte statistikore (nga 65 të planifikuara) gjegjësisht, 123 publikime statistikore. Kurse objektivi për vitin 2022, është në 72 produkte, respektivisht, 144 publikime statistikore. Në proces për vitin 2020, numri i publikimeve statistikore të planifikuara është 134 sosh, sipas normës proporcionale në periudhën pesëvjeçare. Gjendja e përshkruar më lartë është ilustruar përmes Grafikut të mëposhtëm Nr 1.

Grafiku 1. Numri i produkteve të realizuara gjatë vitit 2019, plani 2021 si dhe synimi 2022




Burimi: Gjendja për vitin 2019, të dhënat nga sistemi i SIPK-ut, kurse plani për 2020- 2022, në bazë të normës proporcionale 4% të planifikuar në PSZ 2018-2022.

KVP Treguesi 4 – Ditë pune për produkt

Me qëllim të racionalizimit të resurseve humane, ASK-ja, synim të saj të vazhdueshëm ka rritjen e efikasitetit në procesin e prodhimit statistikor në mënyrë që numri i ditëve për produkt të zvogëlohet nga viti në vit, gjegjësisht, me numër të njëjtë të stafit të arrihet të prodhohet numër më i madh i produkteve statistikore. Në fund të vitit 2019, numri i ditëve për produkt ishte 6548, apo mesatarisht 107.3 ditë pune/produkt. Objektivi për vitin 2022, është zvogëlimi për 10%, respektivisht, në 6256 ditë pune/produkt, kurse për vitin aktual (2020) respektivisht planifikues 2021 synim është zvogëlimi në 6534 respektivisht 6395 ditë pune-person. Të dhënat për vitet 2018 dhe 2019 paraqesin të dhënat e krahasueshme gjegjësisht 58 produktet e krahasueshme, në sistemin e SIPK-ut. Kjo është ilustruar në grafikun e mëposhtëm Nr.2.

Grafiku 2. Numri i ditë pune-person për produkt në vitin 2019 dhe plani për vitin 2021 si dhe synimi 2022



KVP Treguesi 5 - Afati kohor (koha prodhuese²)

Koha prodhuese paraqet kohën e publikimit statistikor nga data e fundit, referuar kohës së hulumtimit deri te dita e publikimit. Prandaj, afati kohor ka rol qendror për vlerësimin e rritjes së efikasitetit në prodhim. Një ndër synimet kryesore të ASK-së, vazhdon të jetë publikimi dhe shpërndarja e të dhënave statistikore sa më shpejtë që është e mundur për shfrytëzuesit. Tanimë disa prej treguesve publikohen në përputhje me standardet e Eurostat-it, si BPV në baza vjetore T+9 muaj në baza tremujore T+90 si dhe në baza mujore T+45 për statistikatat mujore. Ky tregues pasqyron të gjitha aspektet e proceseve, se si është i organizuar procesi i prodhimit, si një tërësi. Në vitin 2019, për 58 produktet, të krahasueshme me një vit më parë, koha prodhuese ishte 9931 apo mesatarisht 170 ditë/publikim statistikor. Ndërsa Koha prodhuese për gjithë produktet statistikore (61) gjatë vitit 219 ishte 10562 ditë kalendarike apo mesatarisht 173 dite për produkt statistikor, respektivisht 86 ditë kalendarike për raport apo publikim statistikor. Synimi për vitin 2021, për të njëjtat produkte është që koha prodhuese të shkurtohet në 10105 edhe përkundër asaj që në PSZ ishte planifikuar në 10325, mirëpo gjatë vitit 2018, kjo komponentë ka pasur efekt jashtëzakonisht të madh sidomos me kalimin e BPV nga T+11 në T+9 muaj, pra shkurtimi i kohës prodhuese është bërë në mënyrë progresive me normën e planifikuar. Ndërsa objektivi i planifikuar, deri në fund të vitit 2022, ishte 9886 respektivisht me (-)10%, por sipas progresit në vitin 2018, kjo ecuri do të jetë më e shkurtër (në 8382 ditë).


Në tabelën e më poshtme dhe Grafikun 3, janë paraqitur koha prodhuese sipas fushave përkatëse statistikore, gjendja në vitin 2018 (viti bazë) dhe synimi në fund të vitit 2022.

Tabela 1. Treguesi 5, Koha e prodhimit

| Fushat statistikore | Viti 2018 | 2018 | 2019 | 2019 | Objektivi 2022 |
|-----------------------------------|-----------|--------------------|------|-------------|----------------|
| | | Të krahasueshme 58 | | Produkte 61 | |
| Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare | 5144 | 6513 | 4816 | 4816 | 4630 |
| Sociale dhe të Popullsisë | 2027 | 2946 | 3119 | 3409 | 1824 |
| Bujqësisë dhe Ambientit | 1519 | 1519 | 1346 | 1687 | 1367 |
| Të Përgjithshme | 623 | 987 | 650 | 650 | 561 |
| Gjithsej (ASK) | 9313 | 11965 | 9931 | 10562 | 8382 |

Në tabelën e mësipërme janë prezantuar të dhënat për kohën prodhuese për vitin 2018, prerje nga fillimi i zbatimit të Programit të dytë 5 vjeçar. Po ashtu janë prezentuar të dhënat për vitet 2018-2019 për produktet krahasuese (58 sosh) si dhe objektivi në fund të Programit të dytë pesë vjeçar 2022. Për të pasur qasje vizuale më të mirë dhe lehtësim në krahasim, këto të dhëna janë paraqitur përmes grafikonit të mëposhtëm, që përshkruajnë objektivin e ASK-së pra ofrimin e të dhënave në kohë optimale tek shfrytëzuesi duke shkurtuar kohën prodhuese nga viti në vit, ashtuqë plani për vitin 2021 është në 10150 ditë kalendarike.

Grafiku 3. Koha prodhuese



²Koha e prodhimit nënkupton numrin e ditëve, nga periudha referuese deri në ditën e publikimit

KVP Treguesi 6 – Saktësia në kohë (shkalla e publikimeve në kohë)


Një nga parimet e Kodit të Parimeve të Statistikave Evropiane (CoP) është publikimi i statistikave zyrtare në kohë, respektivisht saktësia në kohë sipas kalendarit të publikimeve. Ky tregues është pjesë e Sistemit të SIPK-ut dhe çdo devijim nga kalendarit i publikimeve sinjalizohet nga Sistemi operativ i bazës së shënimeve. Në tabelën e poshtëshënuar janë prezantuar të dhënat për numrin e publikimeve në kohë sipas fushave përkatëse të statistikave sektoriale.

Tabela 2. Publikimet në kohë/saktësia në kohë

| Fushat Statistikore | Produkte | Publikime statistikore | Publikuar në kohë | Shkalla 2019 (%) | Plani 2021 | Objektivi 2022 (%) |
|------------------------|-----------|------------------------|-------------------|-------------------|------------|--------------------|
| Ekonomike | 25 | 78 | 73 | 94 | 98 | |
| Bujqësisë | 12 | 17 | 15 | 88 | 95 | |
| Sociale | 17 | 21 | 21 | 100 | 100 | |
| Të përgjithshme | 7 | 7 | 7 | 100 | 100 | |
| Gjithsej | 61 | 123 | 116 | 94.3 | 98% | 100% |

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë nga, gjithsej, 123 publikime të publikuara, 116 apo 94.3% prej tyre janë publikuar në kohën e paraparë sipas kalendarit të publikimeve. Synimi për vitin 2021 është që norma e publikimeve të jetë 98 %. Të dhënat e mësipërme janë paraqitur edhe përmes grafikoni të mëposhtëm.

Grafiku 4. Publikimet në kohë të planifikuara dhe të realizuara



Në grafikoni e mësipërm është prezantuar numri i publikimeve statistikore të planifikuara dhe realizuara në kohë, në fund të vitit 2019. Nga gjithsej 123, prej tyre 116 apo 94.3% e publikimeve statistikore, janë publikuar në kohë të saktë, (koha e paraparë me kalendarin e publikimeve dhe në orën e caktuar). Ndërsa plani për vitin 2021 është nga 139 publikime të parapara, prej tyre 137 të publikohen në kohën e paraparë si dhe objektivi që deri në fund të vitit 2022 të gjitha publikimet statistikore të planifikuara të publikohen në kohën e saktë prej 100%.

4.2. *Matja e prodhimit statistikor*

ASK-ja, përveç rritjes së numrit të prodhimeve statistikore, synon përmirësimin e kualitetit të statistikave zyrtare. Si tregues për matjen e përmirësimit të kualitetit në kuadër të PSZ 2018- 2022, janë numri i variablave dhe norma e përfshirjes së publikimeve (treguesve statistikor) të ASK-së, në publikimet e Eurostatit, për vendet e zgjerimit, përfshirë edhe Kosovën, me të dhëna të ndryshme të fushave statistikore. Për ta matur zhvillimin e gamës së prodhimit dhe përafrimin me BE-në janë përdorur tri masa:

- Numri i publikimeve
- Numri i variablave
- Numri i treguesve kryesorë (“Key igures edicion për vendet e zgjerimit”, Eurostat)

Në fund të vitit 2019, ASK, ka arritur të realizoj 61 produkte statistikore, nga të cilat kanë rezultuar 123 publikime statistikore, që krahasuar me fillimin e Programit të parë të Statistikave Zyrtare në vitin 2013, kur ASK-ja kishte publikuar vetëm 79 publikime statistikore, që parqet një rritje të konsiderueshme. Rritja e numrit të produkteve statistikore do të vazhdoj të jetë prioritet edhe gjatë vitit 2021, në mënyrë që kërkesat e shfrytëzuesve të brendshëm dhe të jashtëm të plotësohen në mënyrë optimale.

KVP Treguesi 2 – Numri i variablave


Përshkrimi i variablave ka qenë sfidë për ASK-në për një kohë të gjatë. Megjithatë, ASK-ja, ka në plan, që gjatë vitit 2020 dhe 2021 ta krijojë një sistem për dokumentimin e variablave komform definicioneve ndërkombëtare në fushën e statistikave.

Në fund të vitit 2017 është bërë përshkrimi i 36 produkteve (metadadave) në ESMS dhe 5 produkteve në ESQRS. Ndërsa, gjatë vitit 2019, është bërë përshkrimi edhe për 5 produkte në ESQRS. Përshkrimi i variablave nuk është përfshirë në këtë proces. Megjithatë, ASK-ja, ka në plan, që deri në fund të vitit 2020 ta krijojë një sistem për të filluar me dokumentimin e variablave komform definicioneve ndërkombëtare në fushën e statistikave.

KVP Treguesi 3 - Numri i treguesve kryesorë (Key figures on enlargement countries, Eurostat edition 2019)

Përmes këtij treguesi, ASK, synon monitorimin e përfshirjes së ASK me të dhënat e saj në publikimet e Eurostat-it për vendet e zgjerimit. Sipas publikimit të fundit (Key figures on Enlargement countries, Statistical Book Edition 2019), në fund të vitit 2019 nga 115 tregues (indikatore), ASK është përfshirë me 79 indikatorë. Kjo rritje është planifikuar me 4% proporcionalisht për vitin vijues.

Grafiku 5. Pjesëmarrja e Kosovës me të dhëna në Key Figures on Enlargement Countries Edition 2019 (Publikim i Eurostat-it)



Nga të dhënat e prezantuara në grafikun e mësipërm, pjesëmarrja e Kosovës në numrin e përgjithshëm të indikatorëve në botimin e sipërpërmendur është me 79 tregues, apo rreth 69%, ndërsa në vitin 2012 ishte 45%, ndërsa në raport me edicionin e vitit 2017 është rritur mbi 5%, e cila është në proporcion pak më të ulët (79/75 në raport me 115/106) me numrin e përgjithshëm e cila shfaqet me një shkallë prej më shumë se 8% respektivisht nga 106 në 115 tregues. Monitorimi do të vazhdoj edhe në vitet në vijim.

4.3. Cilësia

Sipas Ligjit për Statistika Zyrtare, të dhënat grumbullohen, përpunohen, prodhohen dhe shpërndahen në bazë të standardeve dhe metodave të harmonizuara të Eurostatit. Gjatë të gjitha proceseve të lartcekura zbatohen komponentët e cilësisë si: relevanca, saktësia, afatet kohore, saktësia në kohë, qasja dhe qartësia, krahasueshmëria si dhe koherenca.

Me realizimin e PSZ 2013-2017 dhe vazhdimësinë e zbatimit të PSZ 2018-2022 si dhe Planit Vjetor 2019 është arritur progres në seritë kohore dhe matjen e vlerësimit të gabimeve në mostër, ndërsa gjatë periudhës 2021 e deri në vitin 2022, do të kushtohet rëndësi e veçantë përmirësimit të cilësisë. Në raport me përdoruesit, janë realizuar dy anketa: Anketa e Kënaqshmërisë së Përdoruesve (AKP) për herë të dytë, si dhe Anketa e Kënaqshmërisë së Stafit të ASK-së (AKS) për herë të parë.

Për vitin 2021, ASK-ja ka planifikuar ta vazhdojë përmirësimin dhe zhvillimin e procesit të dokumentimit për metodat e prodhimit (metadat). Gjithashtu do të vazhdohet me zbatimin e dy llojeve të vlerësimit. Njëri është vlerësimi teknik, që përqendrohet në metodat dhe dokumentimin e prodhimit (metadata) dhe tjetri është i orientuar drejt përdoruesit, që synon ta përmirësojë kënaqshmërinë e përdoruesit, duke i plotësuar në vazhdimësi kërkesat e tyre.

Zbatimi i rekomandimeve nga grupi i ekspertëve përmes procesit "Peer Review" 2017 në sistemin Statistikor të Kosovës mbetet një ndër qëllimet e komponentës së cilësisë, me theks të veçantë në fuqizimin e metadave dhe aplikimit të modeleve statistikore si GSPBM.

KVP Treguesi 7 - Publikimi i serive kohore

Për hirë të konistencës në të dhëna, hulumtimet e reja në tri vitet e para publikohet si pilot rezultate, Një parim që vazhdon të zbatohet në ASK, konsiston në atë që publikimi i të dhënave në mënyrë të rregullt bëhet në seri kohore, të paktën për një periudhë trevjeçare. Para fillimit të publikimit të rregullt, ASK, fillon me fazën testuese të publikimit deri në sigurimin e saj. Të dhënat kanë treguar qëndrueshmëri nga viti në vit dhe vazhdon publikimi i tyre i rregullt në seri kohore. Në fund të vitit 2019, nga 123 publikime të gjitha ishin në seri kohore. Gjatë vitit 2019 ka vazhduar prodhimi i disa raporteve referuese të cilat janë në fazën testuese të realizimit si, anketa e kostos së punës, etj.

KVP Treguesi 8 – Vlerësimi i gabimeve në mostër

Një ndër komponentët kryesorë të cilësisë është saktësia e të dhënave, respektivisht matja e intervalit të besueshmërisë së të dhënave statistikore. Për anketa me mostër, gabimi i mostrës dokumentohet në përshkrimin e produktit. ASK-ja ka bërë vlerësimet e gabimeve në mostër për disa anketa.

Llogaritjet e gabimit në mostër për Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP) dhe për Anketën e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK), janë bërë gjatë vitit 2017-2018 dhe të njëjtat janë publikuar gjatë vitit 2019. Vlerësimi i gabimit në mostër, do të zbatohet edhe të anketat e tjera statistikore.

Duke u bazuar në rezultatet e realizimit të PSZ 2013-2017, objektivit për Cilësinë në PSZ 2018- 2022 dhe procesit të realizimit gjatë vitit 2019, në vitin 2021 synohet avancimi në zbatimin e të gjitha komponentëve të cilësisë.

4.4. Korniza e planifikimit

Procesi i planifikimit, është i bazuar në kornizën ligjore, respektivisht, Ligjin mbi Statistikat zyrtare. I njëjti ligj përcakton edhe obligimet, përmbytjen dhe afatet kohore për hartimin e Programit afatgjatë statistikor, andaj si instrument zbatues, Plani Vjetor është i bazuar në Programin e Statistikave Zyrtare, në periudhën afatmesme 2018-2022, që përfshinë objektivat të cilat ASK-ja parashikon ti realizoj. Planifikimi siç është e ditur është njëri ndër fazat më të rëndësishme në procesin e menaxhimit të një institucioni, duke u bazuar në një strukturë të gjërë dokumentimi që adresojnë kërkesat për avancim të Sistemit Statistikor të Kosovës.

Andaj, ASK-ja, është duke i kushtuar rëndësi të veçantë dimensionit të planifikimit, duke marrë për bazë nevojat e shfrytëzuesve për prodhimin e statistikave bazë për vendimmarrësit dhe kërkesat nga procesi i integriteteve Evropiane si, PKZMSA-së, Programit për Reforma në Ekonomi (PRE- ERA), PVPQ, SDGs si dhe dokumenteve të tjera të ASK-së.

Prioriteti i aktiviteteve planifikuese është bazuar në planin operativ, respektivisht, disponueshmërinë e resurseve njerëzore dhe financiare të ASK-së, dhe nevojat e përdoruesve për statistika zyrtare. Riorganizimi është proces dinamik përmes të cilit mundësohet realizimi i objektivave të ASK-së.

4.4.1. Instrumentet e planifikimit

Vetë procesi i planifikimit në ASK, është i bazuar në të dhëna-rezultate. Në PSZ, janë dhënë objektivat dhe prioritetet e caktuara në një shtrirje kohore përkatëse. Andaj, planifikimi bazuar në fakte, është proces i cili po aplikohet në ASK dhe si rrjedhojë gjendja në vitin aktual shërben si bazë për Planin e vitit të ardhshëm. Planifikimet e publikimeve statistikore dhe Pasqyra e prodhimit, dihet në çdo kohë, përmes procesit të SIPK-ut dhe KVP. Të dhënat nga viti paraprak, shërbejnë si pikënisje për vitin e ardhshëm dhe që nga viti 2017, ASK-ja ka filluar së zbatuari, një vegël aplikative (interface) për shpërndarjen e numrit të ditëve për produkt në formë elektronike e cila shërben si bazë krahasuese gjatë procesit prodhues.

Përveç Planit vjetor të punës, i cili bazën e ka tek PSZ, procesi i planifikimit është i shoqëruar edhe me dokumente të tjera të rëndësishme si: Harta Rrugore, PKZMSA, Programi për Reforma në Ekonomi, Plani Vjetor i Punës së Qeverisë në fushën e statistikave si dhe nga kërkesa dhe raporte të ndryshme qoftë të brendshme apo ndërkombëtare, në fushën e statistikave.

Përveç instrumenteve nga aspekti i brendshëm ASK-ja, përdorë edhe instrumente tjera në rrafshin ndërkombëtar, të cilat shërbejnë si input për planifikimin e aktiviteteve në ASK. Rekomandimet nga Raporti i Progresit, rekomandimet nga Raporti "Peer Review" transformohen në Plan veprimi.

Struktura e PSZ-së, 2018-2022, PVSZ-së dhe KVP-së, ofrojnë mundësi për një kornizë moderne të planifikimit, të bazuar në të dhëna, duke rritur orientimin e sistemit drejt rezultateve dhe duke ofruar bazën për:

- Procesin e prodhimit të dokumentuar – planifikim dhe zhvillim organizativ;
- Një komunikim transparent dhe të vazhdueshëm me përdoruesit;
- Një dialog transparent dhe të vazhdueshëm me anëtarët e Sistemit dhe Këshillit Statistikor;
- Krijimin sistematik të metadatave (përshkrim i produkteve dhe qasjes metodologjike)
- Vendimmarrja bazuar në rezultate (RBM).

Korniza planifikuese i integron dy fazat me të rëndësishme të një cikli menaxherial planifikues, siç janë Planifikimi dhe Raportimi, duke nënkuptuar se Plani Vjetor është i bazuar drejtpërdrejt në vlerësimin e performancës në të kaluarën përmes analizës në indikatorët e gjeneruar nga sistemi i SIPK-ut dhe njësisve tjera përkatëse.

KVP-ja, krijon Sistemin e Përfshirjes së Kohës, për monitorimin e shpërndarjes së punës ditore për burime njerëzore. Raportet nga sistemi ju mundësojnë menaxherëve të ASK-së, t'i identifikojnë vështirësitë dhe nevojat për kapacitete dhe t'i ri aranzhojnë proceset, e punës për një efikasitet sa më të madh. Ky sistem u ofron menaxherëve një pasqyrë të vlefshme, gjegjësisht të nevojshme për ta mundësuar bashkëveprimin ndërmjet njësisve të ndryshme punuese të ASK-së. Sistemi i përfshirjes së kohës është avancuar nga viti në vit dhe do të vazhdojë të avancohet duke përfshirë module të reja, deri sa të arrihet në Sistem për Menaxhimin e Performancës.

Në vitin 2020, ASK-ja, ka në proces

- Hartimin e Planit Vjetor, për vitin 2021;
- Zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022;

- Përafrimin e Kornizës Ligjore me ACQUIS;
- Vazhdimin e komunikimit me përdorues;
- Zbatimin e rekomandimeve nga ekipi i eksperteve të Eurostat-it nga Procesi "Peer Review" (2017-2022);
- Rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve administrative dhe profesionale të ASK-së;
- Avancimin e KVP-së, si dhe fuqizimi i kapaciteteve për analiza të performancës (raporte analitike, moduli i vlerësimit të kostos së produktit statistikor, etj.);
- Digjitalizimin, gjegjësisht përdorimin e pajisjeve për mbledhjen e të dhënave për anketa në terren si dhe krijimin e sistemeve të avancuara për shkëmbimin e të dhënave ndërinstitucionale;
- Përgatitjen e infrastrukturës së TI-së për organizimin dhe mbarëvajtjen e Regjistrimit të Popullsisë 2021;
- Avancimin e sistemit SDMX për shkëmbimin e të dhënave mes ASK dhe institucioneve ndërkombëtare;
- Avancimin e sistemit të metadatave SIMS dhe integrimi i sajë në ueb faqen e ASK;
- Fuqizimin e sistemit për shpërndarjen e të dhënave përmes platformës ("ASKDATA");
- Mirëmbajtjen e ueb-faqes së re të ASK-së;
- Menaxhimin e bazuar në rezultate (RBM);
- Dokumentimin variablave dhe produkteve statistikore (metadata);
- Planin e veprimit, PKZMSA;
- PVPQ;
- Fuqizimin e koordinimit të Sistemit Statistikor të Kosovës;
- Realizimin e Pilot Regjistrimit të Popullsisë në muajin prill 2021 (nëse e lejon gjendja e COVIT-19);
- Projekt Ligjin për Projektin e Regjistrimit të Popullsisë 2021.

Në vitin 2021, ASK-ja, planifikon:

- Hartimin e Planit Vjetor, për vitin 2022;
- Zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022;
- Zbatimin e Planit të veprimit nga procesi "Peer Review";
- Zbatimin e kornizës ligjore me ACQUIS;
- Rritjen e bashkëpunimit dhe komunikimit me përdorues;
- Rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve administrative dhe profesionale të ASK-së;
- Avancimin e KVP-së si dhe fuqizimi i kapaciteteve për analiza të performancës; (raporte analitike, moduli i vlerësimit të kostos së produktit statistikor, etj.);
- Digjitalizimi i anketave në terren si dhe krijimi i sistemeve të avancuara për shkëmbimin e të dhënave ndërinstitucionale;
- Promovimi gjithnjë e më shumë i platformës ASKDATA;
- Dokumentimin e variablave dhe produkteve statistikore (metadata);
- Planin e veprimit, PKZMSA 2022-2025;
- PVPQ 2022;
- Realizimin e Regjistrimit të Popullsisë, 2021 (nëse lejon gjendja nga COVIT-19)
- Platformën e SGDs

4.4.2. Riorganizimi

Duke u bazuar në raportet e gjeneruara nga SIPK-u, me qëllim të racionalizimit të vendeve të punës dhe prioriteteve të përgjithshme të ASK-së, procesi i riorganizimit do të zbatohet sipas Rregullores Nr. 01/2013, për riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në ASK, deri në nivel departamenti. Gjatë periudhës së ardhshme planifikohen këto veprime:

1. Racionalizimi i vendeve të punës në ASK, përmes transfereve të brendshme, bazuar në KVP;
2. Fuqizimi i kapaciteteve njerëzore në statistikave sociale, ekonomike, të bujqësisë dhe në TI.

Me qëllim të plotësimit të kërkesave të përdoruesve të statistikave zyrtare, riorganizimi në ASK, do të jetë një proces i vazhdueshëm, por duke u bazuar në Rregulloren përkatëse për Riorganizim.

4.5. Kënaqshmëria e përdoruesve

Kontaktet me përdoruesit e të dhënave janë thelbësorë për përmirësimin e cilësisë dhe për zhvillimin e përmbajtjes së statistikave. Një mënyrë e rëndësishme për vlerësimin e cilësisë është matja e kënaqshmërisë së përdoruesve.

Bazuar në Ligjin e ri për Statistika Zyrtare, do të bëhet Udhëzimi Administrativ për Mbrojtjen e të Dhënave Statistikore, duke përfshi edhe pjesën e qasjes së përdoruesve në të dhënat statistikore.

Gjatë gjithë kohës, ASK-sja ka zhvilluar takime dhe ligjërata me shfrytëzues kryesor të të dhënave, me qëllim të identifikimit të nevojave për të dhëna statistikore dhe matjen e nivelit të kënaqshmërisë për të dhënat e publikuara nga ASK-ja.

ASK-ja, po ashtu në kuadër të kënaqshmërisë së përdoruesve do të organizoj në vitin 2021 Anketën e Kënaqshmërisë së Përdoruesve (AKP).

Do të vazhdohet me avancimin e ueb-faqes së ASK-së me qëllim të plotësimit të nevojave të përdoruesve për të dhëna statistikore, si dhe ta bëjë më të lehtë qasjen nga shfrytëzuesit.

4.6. Përmbledhja e vlerësimit të performancës

- Prodhimet statistikore dhe publikimet statistikore, deri në fund të vitit 2019 janë rritur për 22 sosh, në krahasim me vitin 2012, respektivisht, nga 39 në 61 produkte statistikore, ndërsa numri i publikimeve statistikore për të njëjtin interval kohor është rritur nga 79 sa ishte në vitin 2012 në 123 në fund të vitit 2019. Shprehur në strukturë është shënuar rritje mbi 56% për produkte statistikore, gjegjësisht, 55.7% për publikime statistikore.
- Numri i variablave është proces dhe deri me tash ka qenë sfiduese për ASK-në. Kjo sfidë do të na përcjellë deri në finalizimin e plotë të procesit të dokumentimit të variablave. Është paraparë që deri në fund të vitit 2022, të bëhet përshkrimi i variablave statistikore, me rreth 50% e tyre.

- Norma e përfshirjes së publikimeve statistikore të Kosovës, gjegjësisht, përfshirja e Kosovës, me të dhëna (tregues, tabela, grafikone, etj.) në publikimin e Eurostatit mbi vendet e zgjerimit të titulluar “Key figures on enlargement countries edition 2019” është e përfshirë me 79 indikatorë nga gjithsej 115 tregues. Krahasuar me vitin 2012, në fund të vitit 2019 ka një rritje të normës së përfshirjes në këtë publikim në shkallën prej 24% më shumë, respektivisht, nga 45, në vitin 2012 në 69 % në vitin 2019
- Rritja e efikasitetit është evidente edhe gjatë vitit 2019, nga se gjatë vitit 2019, mesatarisht janë shpenzuar rreth 107 ditë pune për produkt (61 produkte), në krahasim me vitin 2018, që është 115 ditë pune (61 produkte). Ndërsa matja e performancës për 58 njësi bëhet me qëllim të krahasueshmërisë me një saktësi më të qartë për matjen e performancës nga viti në vit. Për derisa në vitin 2018, për prodhimin e një produkti statistikor ishin shpenzuar mesatarisht 118 ditë, në vitin 2019, për të njëjtat produkte janë shpenzuar rreth 113, ditë për produkt statistikor, pra, kemi një rritje të efikasitetit, në shkallë për -4.2 % gjegjësisht më pak ditë të harxhuara në të njëjtat produkte;
- Koha prodhuese, respektivisht, afatet kohore (një nga parimet e CoP), ka shënuar përmirësim edhe në vitin 2019, krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2019 koha prodhuese për të gjitha produktet (61) ishte 10562 ditë kalendarike.
- Megjithatë, matja e performancës më e qartë është vetëm atëherë kur matja bëhet duke krahasuar kohën prodhuese të vitit 2019 me atë të 2018, për të njëjtat produkte statistikore (58). Përderisa në vitin 2018 koha prodhuese për 58 njësi ishte regjistruar 11965 ditë kalendarike, në vitin 2019 koha prodhuese për të njëjtat produkte është shkurtuar në 9931 ditë kalendarike. Mesatarisht për produkt 171 ditë në vitin 2019, që krahasuar me vitin 2018 mesatarisht për produkt ishte 206 ditë (11965/58). Shprehur në strukturë efektiviteti prodhues është rritur për 1034 ditë apo rreth -9% shkurtim i kohës prodhuese. Me fjalë të tjera mesatarisht rreth 18 ditë secili produkt ju është ofruar shfrytëzuesit më shpejtë në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018. Plani për vitin 2021 është që të shkurtohet koha prodhuese në -4% në mënyrë proporcionale.
- Saktësia në kohë, në vitin 2019, është regjistruar në shkallën prej 94.3%, të raporteve në kohë, krahasuar me vitin 2018, ku norma e publikimeve në kohë ishte në shkallën prej 97%, gjegjësisht nga 123 publikime, prej tyre 116 janë publikuar në kohën e saktë. Shkaqet janë të natyrës tekniko administrative si, fuqizimi në proces i kapaciteve profesionale dhe resurseve të nevojshme humane në fusha të caktuara. Synimi i ASK-së, është publikimi i të gjitha publikimeve statistikore në kohën e caktuar sipas kalendarit të publikimeve. Pra, KVP në vetvete është një vegël e cila i shërben menaxhmentit të ASK për të thelluar analizën në të gjeturat e raportit. Rënia e normës së publikimeve nga 99 në 94 është si pasojë e ngecjes në sigurimin e të dhënave me kohë nga palët e treta gjegjësisht responentët (burimet administrative) dhe kapacitetet tekno profesionale në zhvillim në fusha të caktuara.
- Vlerësimi i gabimit në mostër ka filluar si proces gjatë viteve 2014-2015. Në këto vit janë bërë llogaritjet e vlerësimit të gabimit në mostër për dy anketa, si AFP dhe TIK-ut. Ndërsa, gjatë viteve në vijim ASK- ja do të vazhdojë me publikimin e vlerësimit të gabimit në mostër dhe koeficientit të variacionit edhe për produktet e tjera, si Anketa Strukturore e Bizneseve (ASB) dhe Anketat e tjera në PSZ.

Koha e raportimit është proces i vazhdueshëm, i cili gjatë vitit 2019 në krahasim me një vit më parë ka pasur kontinuitet të ngjashëm me vitin 2018 në shkallën prej rreth 94%.

Tabela 3. Përmbledhje ekzekutive e periudhës 2013-2017, gjendja 2019 si dhe plani 2021

| Treguesit | PSZ (2013-2017) | | Norma+/- | PSZ (2018-2022) | | |
|----------------|-----------------|---------|----------|-----------------|----------------|-----------|
| | 2013 | 2017 | | % | 2019 Realizuar | 2021 Plan |
| Produkte | 39 | 60 | +54 | 61 | 70 | 72 |
| Publikime | 79 | 120 | +52 | 123 | 139 | 144 |
| Ditë-njërëz | 147 | 138 | -6 | 113 | 107 | 104 |
| Koha prodhuese | 6278 | 5849 | -7 | 9931 | 10105 | 8382 |
| Norma | 49/79 | 120/121 | 62/99 | 116/123 | 137/139 | 144/144 |

Burimi: ASK, të dhënat nga SIPK-u, Programi 2013-2017, matja e performancës është bërë për 39 produkte (baseline). Ndërsa Matja e performancës për periudhën 2018-2022 është bërë në bazë të 58 njësisve krahasuese me një vit më parë (Në vitin 2018, koha prodhuese prej 11965 është për 58 produktet , e jo 39, të dhënat në vitin 2019 janë të dhënat reale të regjistruara nga SIPK-u, të krahasueshme me të njëjtat produkte të një viti më parë).

Nga të dhënat e prezantuara në tabelë, gjatë tërë ciklit të Programit të Statistikave zyrtare, ASK, i ka kushtuar rëndësi të veçantë procesit të monitorimit të zbatimit të objektivave të caktuara në Programin 5 vjeçar 2013-2017. Po ashtu edhe në Programin e dytë të Statistikave Zyrtare 2018-2022, monitorimi është dimension mjaft i rëndësishëm në procesin menaxhimit. Në programin e dytë, normimi në objektivat afatgjatë ka ndryshuar për shkak të arritjes në zenit që mund të ketë turrja e mëtejme e kohës së nevojshme për prodhimin e një produkti statistikor apo edhe kufizimeve proporcionale me resurset humane dhe proceset tjera jashtë ASK-se, si psh (mos)

sigurimi më i shpejtë i të dhënave nga burime administrative për shkak të proceseve të nevojshme që kërkohen. Të dhënat me baza tremujore, mujore, vjetore, kërkohen kohën e vetë të raportimit.

Ndër synimet kryesore të Programit, ASK, ka në fokus të vazhdueshëm dy prej tyre; rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit prodhues. Numri i publikimeve statistikore është rritur në shkallën prej 54%, krahasuar me objektivin To +16%, respektivisht gjendja në fund të vitit 2017 nga gjendja në fillim të vitit 2013, me 46 produkte statistikore. Por në bazë të performancës së ASK-së, në fund të vitit 2017 janë publikuar 60 produkte statistikore dhe 120 publikime. Në anën tjetër efikasiteti prodhues, gjegjësisht, racionalizimi i resurseve njerëzore, ka rezultuar që me të njëjtat burime ka arritur të prodhojë numër më të madh të produkteve statistikore, duke nënkuptuar zvogëlimin e kohës së angazhuar në procesin e prodhimit statistikor.

Gjatë vitit 2019, të dhënat e prezantuara në tabelën e mësipërme tregojnë përmbushjen e qëllimeve të ASK-së duke zvogëluar kohën e angazhuar (numrin e ditë-pune-njërëz) si dhe shkurtimin e afateve prodhuese gjegjësisht, ofrimin më të shpejtë të produkteve statistikore tek shfrytëzuesit. Për vitin 2021, është planifikuar shkurtim i kohës prodhuese dhe numrit të ditëve për produkt në mënyrë proporcionale sipas objektivave në PSZ 2018-2022, si dhe rritje të normës së publikimeve në kohë në shkallën prej 98 % në vitin 2021, gjegjësisht 100% në fund të vitit 2022.

Saktësia në publikimin e statistikave zyrtare në vitin 2019, në raport me vitin 2013, ka shënuar progres të jashtëzakonshëm nga 79, prej tyre 49 publikime ishin publikuar në kohë në vitin 2013 (62%), ndërsa në vitin 2019, nga gjithsej 123 publikime 116 janë publikuar në kohën e saktë, apo 94.3% e publikimeve të parapara në kohën e saktë.

5. PLANI I VEPRIMIT VJETOR 2021

5.1. Prioritetet strategjike

Viti 2018 ishte viti i parë i zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022. Prioritetet strategjike në P5SZ 2013-2017, ishin përmbushur në masën më të madhe të saj. Çështjet e hapura si korniza ligjore, riorganizimi dhe burimet financiare e njerëzore mbeten pjesë e programit të dytë si rezultat i faktorëve të jashtë në realizimin e tyre. Megjithatë, ato vazhduan të jenë pjesë e PSZ 2018-2022 dhe si të tilla do të shtjellohen në vijim për ecurinë, gjegjësisht, realizimin e tyre gjatë planit të parë dhe të dytë të punës 2018 respektivisht 2019, brenda kësaj kornize kohore (2018-2022). Në pjesën 4.3 të Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022³, janë paraqitur prioritetet strategjike, të cilat ndahen sipas fushave organizative dhe statistikore. Lidhur me zhvillimin organizativ, ky Program Pesëvjeçar përcakton 6 prioritetet strategjike, ndërsa prioritetet e planifikuara janë si më poshtë:

Konsolidimi i Kornizës Ligjore – Pas aprovimit (në fund të muajit dhjetor 2018), të Ligjit me ndryshim plotësime të Statistikave Zyrtare, ASK-ja ka ndërmarrë veprimet apo masat e nevojshme për të plotësuar dhe zbatuar dispozita të veqanta që burojnë nga Ligji i sipërpërmendur. Përveq tjerash, ASK-ja ka inicuar hartimin e dy draft udhëzime administrative me qëllim të funksionalizimit dhe zbatimit të Ligjit për Statistika Zyrtare, Draft Udhëzimi Administrativ për Konfidencialitetin e të Dhënave të Statistikave Zyrtare si dhe Draft Udëzimin Administrativ për Shitjen e të Dhënave Statistikore. Të dy udhëzimet administrative janë të përfshira në agjendën e Qeverisë për vitin 2020 dhe në kohën optimale pritjet të dërgohen në Qeveri për shqyrtim.

Regjistrimi i Popullsisë 2021 - Është bërë Harta Rrugore dhe Plani i Projektit për Regjistrimin e Popullsisë 2021 duke përfshirë edhe Planin Buxhetor për realizimin e projektit. Koncept Dokumenti për Regjistrimin e Popullsisë dhe draftimi i Ligjit për RP 2021 janë në proces dhe është planifikuar të përfundojnë gjatë vitit 2020, ndërsa deri në tetor të vitit 2020 (varet nga gjendja e shkaktuar nga pandemia COVIT-19), është parashikuar të realizohet Pilot Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave. Përkundër të gjitha përgaditjeve të nevojshme, për shkak të Covid 19, aktivitetet e planifikuara ka gjasë të shtyhen për kohë të pacaktuar. Megjithatë ende planifikohet se Regjistrimi i Popullsisë të mbahet në vitin 2021.

Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë AGTSH (MICS6) është një prioritet mjaft i lartë, ku aktivitetet operative janë zhvilluar në terren në pjesën e dytë të vitit 2019, ndërsa Raporti pritjet të publikohet gjatë vitit 2020. MICS6 është një nga anketat më të mëdha të zhvilluara në ekonomi familjare, e cila zhvillohet për herë të dytë në Kosovë. Ky është raundi i gjashtë i MICS-it në nivel global, që përdorë metodologjinë ndërkombëtare të standardizuar, me qëllim të informimit të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG). Nga MICS6 do të gjenerohen të dhënat për më shumë tregues në kuadër të objektivave të SDG-ve.

Fuqizimi dhe funksionalizimi i plotë i Departamentit të Llogarive Kombëtare - Siç është cekur më lartë një ndër shtyllat e programit është procesi organizativ prodhues. Gjatë vitit 2018 është bërë ndarja e Llogarive Kombëtare nga Statistikat Ekonomike me qëllim të zvogëlimit vertikal dhe shtrirjes horizontale në proceset statistikore. Gjatë vitit 2019, ASK, ka arritur që të funksionalizojë tërësisht DLLK-në, me stafin përkatës dhe procesi i prodhimit vazhdon të kontribuojë në realizimin e objektivave të ASK-së.

Për vitin 2020-21, DLLK, ka në plan që të vazhdoj me publikimet e GDP-së në baza tremujore dhe vjetore, po ashtu edhe me Llogarite Qeveritare në baza tremujore dhe vjetore. Ndërsa sa i takon Ekonomisë së Pavrojtuar, objektivi është që rezultatet e Anketës mbi Ekonominë e Pavrojtuar të integrohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare sipas aktiviteteve dhe të vazhdohet me matjen e Ekonomisë së Pavrojtuar në aktivitete të reja përveç atyre të përfshira në Anketë. Vlenë të theksohet se varësisht nga ndikimi i gjendjes së shkaktuar nga COVID-19, planifikohet që vazhdohet me realizimin e revidimit të të dhënave në BPV në nivel vendi.

Zhvillimi i kapaciteteve të tjera – ASK, ka synim të vazhdueshëm ngritjen e kapaciteteve administrative dhe tekniko profesionale të ASK-së. Gjatë vitit 2019 dhe 2020 në bazë të Planeve të Punës për vitet përkatëse, realizimi i këtij prioriteti ka shënuar progres përmes aprovimit të pozitive të reja nga Institucionet e Republikës së Kosovës. Gjithashtu stafi i ASK-së, ka participuar në takime të shumta horizontale të cilat kryesisht kanë qenë të organizuara nga Eurostat-ti, në fusha të ndryshme statistikore, si ekonomike, sociale, të punësimit, bujqësisë, etj. Përafërsisht rreth 125 aktivitete brenda vitit janë organizuar nga Eurostat-i dhe në secilën prej tyre, ASK-ja ka qenë e përfaqësuar qoftë në nivel rajonal apo në nivel të Eurostat-it në forma dhe mënyra të ndryshme si takime në grup, seminare, vizita studimore, punëtori etj. Në këtë rrjedhë, ASK-ja planifikon të vazhdoj tutje edhe për vitin 2021 ngritjen e numrit të stafit në bazë të kërkesave për rritje të numrit të hulumtimeve të reja statistikore, si dhe ngritjen e kapaciteteve në prizimin e aplikimit të metodologjisë dhe zhvillimeve më të reja në fushën e statistikave në arenën ndërkombëtare.

Korniza për Vlerësimin e Performancës (KVP) – KVP vazhdon të mbetet një ndër veglat më të rëndësishme në procesin e planifikimit dhe monitorimit të proceseve në ASK. Vendimmarrja e ASK-së ka qenë dhe vazhdon të mbështetet në të dhënat e siguruara nga korniza vlerësuese e performancës. Një nga benefitet e aplikimit të KVP është unifikimi i proceseve dhe fazave në ciklin e planifikimit duke ndikuar në rritjen e efikasitetit në procese statistikore dhe rritjen e cilësisë përmes menaxhimit adekuat të resurseve njerëzore. Për vitin 2021, planifikohet popullimi me të dhëna nga njësitë përkatëse në ASK, pasi që disa prej tyre gjegjësisht 4 tregues nuk furnizohen me të dhëna nga SIPK-u si numri i variablave, vlerësimi i gabimeve në mostër, variablat kryesor të BE-së, etj.

Komunikimi me përdorues - Në fushën e komunikimit me publikun, ASK-ja, po bën përpjekje të vazhdueshme që ta rris bashkëpunimin me përdorues të statistikave zyrtare. Me lehtësirat e mëdha që janë bërë viteve të fundit: me zhvillimin e vazhdueshëm të ueb-faqes së ASK-së, duke e rritur numrin e vizitorëve; me përdorimin e mediave sociale (Facebook), duke i informuar përdoruesit e statistikave zyrtare, në mënyrë të vazhdueshme, për të dhënat më të fundit statistikore, si dhe duke rritur numrin e ndjekësve dhe pëlqimeve të faqes së saj; me komunikimin me media, duke rritur bashkëpunimin dhe kontaktet me gazetarë, si dhe duke rritur numrin e paraqitjeve të stafit të ASK-së në emisione televizive dhe radio; me kontaktet me përdorues (qofshin institucione publike, universitete publike a private, organizata vendore ose ndërkombëtare, apo individë), duke shfrytëzuar instrumente dhe metoda të ndryshme, qoftë përmes adresës zyrtare me shkrim, intervistave përmes telefonit, xhirimeve me kamerë, dhe përmes mediave sociale. ASK-ja gjithnjë e më shumë po angazhohet që t'u dalë mbanë kërkesave, sidomos nga studentët hulumtues kandidatë të PhD-së, në mënyrë që të bëhen analiza shkencore me të dhëna të besueshme statistikore.

³ Programi i Statistikave Zyrtare 2018-2022, do të përfshijë prioritetet strategjike për periudhën 5 vjeçare dhe zbatimin e tyre do të shtrihet në kohë dhe do të zbatohet përmes planeve vjetore të punës. Hartimi do të bëhet pasi të jetë vlerësuar SSK, nga Eurostat.

Të gjitha raportet rreth komunikimit dhe informimit të përdoruesve tregojnë se performanca e ASK-së ndaj kësaj pjese të përdoruesve është rritur në raport me pritjet e tyre.

Gjatë vitit 2021, synimi i ASK-së është avancimi i dialogut me të gjithë përdoruesit e statistikave zyrtare. Kjo përfshinë edhe vendosjen e një koordinimi dhe bashkëpunimi me institucionet, që janë burim dhe njëkohësisht përdorues të të dhënave të ASK-së. Për realizimin e këtij synimi, ASK-ja në vazhdimësi do të mbajë takime me shfrytëzues të ndryshëm sipas grupeve të caktuara të interesit për identifikimin e nevojave për të dhëna të reja statistikore dhe rritjen e cilësisë sipas kërkesave të shfrytëzuesve.

ASK-ja, përmes marrëveshjeve së mirëkuptimit (MeM) ka rritur nivelin e koordinimit dhe të bashkëpunimit me institucione, që janë shumë të rëndësishme lidhur me burimin e të dhënave administrative. Gjithashtu, ASK-ja ka në plan t'i freskojë MeM-të, të nënshkruara vite më parë. Koordinimi dhe bashkëpunimi me përdoruesit ka arritur një nivel të kënaqshëm.

ASK-ja, mban kontakte të rregullta me përdoruesit e të dhënave për Llogaritë Kombëtare dhe të Tregut të Punës. Këto kontakte i organizon në baza të rregullta para publikimit të rezultateve. Sa i përket bashkëpunimit me përdoruesit ndërkombëtarë, planifikohet thellimi i tij. Tashmë, përmes Programit eDAMIS, ASK-ja vazhdon dërgimin e të dhënave në Eurostat. Për vitin 2021 planifikohet që përveç rritjes së komunikimit me përdorues, të zbatohen edhe dy Udhëzime Administrative të cakura më lartë, rreth qasjes në të dhëna statistikore dhe shitjen e tyre.

Zbatimi i Planit të Veprimit nga Vlerësimi i Sistemit Statistikor të Kosovës - gjatë vitit 2019 është dërguar në Eurostat Raporti i dytë me zbatimin e rekomandimeve dhënë nga ekipi i ekspertëve të Eurostatit, si rezultat nga Vlerësimi i Sistemit Statistikor përmes procesit "Peer Review". Për vitin 2020 dhe 2021 procesi i zbatimit të rekomandimeve vazhdon në përputhje me Planin e veprimit i cili tashmë është i publikuar në ueb faqen e ASK-së dhe Eurostat-it.

Prioritetet e tjera sektoriale - Zhvillimi i mëtejshëm të Llogarive Kombëtare, zbatimi i metodologjisë së ESA 2010, shkurtimi i afateve të Llogarive Kombëtare tremujore, rritja e numrit të tabelave me të dhëna për dërgim në Eurostat, përpilimi i Llogarive Sektoriale, përpilimi i tabelave ofruese përdoruese (SUT), tabelave input output (IOT), përpilimi i llogarive regjionale, përpilimi i BPV-së sipas qasjes së të ardhurave, vazhdojnë të jenë prioritetet gjatë vitit 2021.

Shkurtimi i afateve kohore për publikimet e Llogarive Qeveritare dhe rritja e numrit të tabelave me të dhëna të cilat dërgohen në Eurostat. Matja e shkallës së Ekonomisë së Pavrojtuar sipas aktiviteteve dhe integrimi i rezultateve në Bruto Produktin Vendor, në mënyrë që të sigurohet mbulueshmëri e plotë e Llogarive Kombëtare.

Gjithashtu, ASK-ja do të vazhdojë me përmirësimin e cilësisë së Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, me zhvillimin e Statistikave të Investimeve, zhvillimin e Statistikave të Ndërtimit, zhvillimin e Statistikave mbi përdorimin e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit në Biznese, zhvillimin e Statistikave mbi Shërbimet.

Në fushën e Statistikave Sociale, ASK-ja planifikon shtimin e moduleve të reja dhe publikimin e të dhënave në baza mujore për AFP-në, prioritet i lartë mbetet zhvillimi i Anketës mbi Koston e Punës, zhvillimi i Anketës për Vendet e Lira të Punës (JVS) si dhe Anketën mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (SILC). Trajtim të veçantë do të kenë Klasifikimet - ISCED 2011 në fushën e Arsimit, Klasifikimi i Krimeve dhe vendosja e kodeve të krimeve për nevoja statistikore.

Në aspektin e cilësisë prioritet do të jenë: relevanca, korrektësia, afatet kohore, saktësia, qasja dhe qartësia, krahasueshmëria dhe koherenca. ASK-ja përmes themelimit të Këshillit për Menaxhimin e Cilësisë, do ta menaxhoj dhe angazhohet për rritjen e vazhdueshme të cilësisë. Do të bëhet zhvillimi i një Sistemi Qëndror të Harmonizuar Metadash, në përputhje me rekomandimet e Sistemit Statistikor Evropian (Euro SDMX Metadata Structure) dhe ESQRS (ESS Standart Quality Report Structure), i cili do të mundësoj gjenerimin e raporteve të cilësisë në databazën e Eurostatit. Zbatimin e Strategjisë për Diseminimin dhe avancimi i saj, do të jetë po ashtu prioritet. Është planifikuar që procesi i shpërndarjes së të dhënave të pasurohet me sa më shumë udhëzime, sqarime moderne dhe figurative, forma moderne të tabelave dhe grafikëve, si dhe pasurimin e ueb faqes me të gjitha veglat moderne të shpërndarjes së të dhënave statistikore. Me qëllim të rritjes së burimeve administrative të të dhënave, do të vazhdohet të modernizohet infrastruktura e TI-së, duke përdorur sa më shumë baza të shënimeve dhe regjistra elektronikë.

Bazuar në përgjegjësitë nga Ligji i ri për Statistikat Zyrtare, ASK-ja në vazhdimësi do të zhvilloj projekte të reja me qëllim të rritjes së numrit të indikatorëve. Prandaj, edhe gjatë vitit 2021, ASK-ja do të vazhdojë me realizimin e projekteve të tilla sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, me qëllim të avancimit të Sistemit Statistikor të Kosovës.

Modernizimi i proceseve statistikore në ASK është duke u zhvilluar në vazhdimësi, në mënyrë që t'i përafrojë statistikën e Kosovës me ato të vendeve të Bashkimit Evropian dhe standardeve të Eurostat-it. Për këtë qëllim është planifikuar të aplikohen metodologji të reja, për t'i grumbulluar (forma elektronike e mbledhjes së të dhënave) dhe përpunuar më shpejtë të dhënat statistikore. Gjithashtu, ASK-ja, do ta ketë në konsideratë progresin e bërë nga agjencitë e tjera publike dhe t'i shfrytëzojë arritjet e tyre për nevojat e saj.

5.2. Tabela përmbledhëse e zhvillimit organizativ më 2021

Zhvillimi synon përmirësimin e efikasitetit të prodhimit dhe PSZ paraqet katër prioritetet vepruese për vitin 2021.

| Brenda Kornizës së burimeve ekzistuese | Objektivi dhe përgjegjësia | Statusi 2019/2020 dhe plani 2021 |
|--|--|---|
| Korniza e Vlerësimit të Performancës (KVP) | <p>Objektivi: Avancimi i një pasqyre të përgjithshme për proceset statistikore në ASK, më qëllim të përfundimit të Kornizës së Planifikimit</p> <p>Përgjegjës: DPPKK</p> | <p>Statusi: SIPK-u është funksional dhe plotësimi i tij me kërkesat e reja nga departamentet do të vazhdojë gjatë vitit 2021. Raporti është plotësuar për 7 nga 8 indikatorët e KVP. Raporti vjetor dhe Plani vjetor përgatitet në bazë të të dhënave nga KVP.</p> <p>Plani: Do të vazhdohet me raportimin mbi 8 indikatorët e KVP, Planifikimi dhe Monitorimi do të vazhdojë në përputhje me KVP me mundësi të avancimit dhe modernizimit të mëtejshëm të SIPK-ut (p.sh. përfshirja e kostos sipas produktit statistikor, freskimi me aktivitete të reja, etj.).</p> |
| Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të DPPKK- së. | <p>Objektivi: Kompletimi me staf i DPPKK-së dhe ngritja e kapaciteteve ekzistuese përmes trajnimeve për planifikim, raportim dhe dokumentim.</p> | <p>Statusi: DPPKK është funksionalizuar, vazhdon të ushtroj detyrat dhe përgjegjësitë e saj në bazë të LSZ dhe rregulloreve për riorganizim të ASK-së. DPPKK është rritur edhe për dy pozita të reja.</p> |

| | | |
|--|---|---|
| | Përgjegjës: DPPKK | Plani: Rritja e kapaciteteve për planifikim dhe zhvillimin e politikave (p.sh. identifikimi i tri masave kryesore si prioritetete) në ASK. Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të stafit krahas zhvillimeve të përgjithshme do të vazhdoj edhe në ta ardhmen. |
| 3 Fuqizimi i rolit të ASK- së në SSK | Objektivi: Koordinimi më i mirë i SSK | Statusi: Këshilli Statistikor është funksional dhe janë të përfaqsuara shumë institucione. Fuqizimi i rolit koordinues të ASK-së është vendosur në ligjin e ri të statistikave zyrtare. |
| | Përgjegjës: DPPKK me institucionet e tjera | Plani: Krijimi i trupave me bazë të gjerë në mes të institucioneve të SSK. Bëhet fjalë për trupa këshillëdhënëse dhe koordinuese në fusha të caktuara të statistikave sektoriale. |
| 4 Zbatimi i Rekomandimeve nga “Peer Review” për DRA. | Objektivi: Racionalizimi i vendeve të punës | Statusi: Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit funksionon sipas përgjegjësisë së tij. Është realizuar lidhja e zyrave rajonale me ASK-në, përmes rrjetit qeveritar të Teknologjisë Informative, si dhe qasja në sistemin e SIPK-ut. |
| | Përgjegjës: DRA | Plani: ASK-ja planifikon për vitin 2021 ngritjen e kapaciteteve dhe modernizimin e mbledhjes së të dhënave, me qëllim të rritjes së cilësisë gjatë mbledhjes së të dhënave, si dhe koordinimin më të mirë të punës në terren. Racionalizimi i pozitave mbetet një objektivë afatgjate, deri në aplikimin e plotë të metodës CAWI për mbledhjen e të dhënave. |
| 5 Mbështetje e avancuar për departamentet prodhuese. | Objektivi: Krijimi i programeve për mbledhjen e të dhënave në terren (metoda CAPI dhe CAWI) si dhe qasja më e lehtë në të dhëna zyrtare përmes ueb faqes së ASK-së. | Statusi: Në ueb faqen e re të ASK-së është integruar platforma ASK Data dhe është në dispozicion për përdoruesit. askdata.rks-gov.net. Është bërë integrimi i mëtejme i mbi 900 tabelave për tema të ndryshme statistikore. Mbi 13 aplikacione janë zhvilluar për 13 anketa përmes metodës CAPI dhe CAWI. |
| | Përgjegjës: DMTI | Plani: Do të vazhdoj procesi i modernizimit dhe i avancimit të metodës CAPI dhe masivizimi i metodës CAWI në procesin e mbledhjes së të dhënave. Avancimi i përmbajtjes së ueb faqes dhe platformës ASKDATA do të jetë i vazhdueshëm gjatë tërë vitit 2021. Aplikimi i video publikimeve në ueb faqe dhe formave të tjera të modernizimit të shpërndarjes së statistikave zyrtare. |

| Jashtë Kornizës së burimeve ekzistuese | Objektivi dhe Përgjegjësia | Statusi 2019/2020 dhe plani 2021 |
|---|---|---|
| 1 Zhvillimi i një sistemi qendror të harmonizuar të Metadatave (SIMS) | <p>Objektivi: Ngritja e kapaciteteve profesionale, dokumentimi i metadatave.</p> <p>Përgjegjës: DMTI në bashkëpunim me Departamentet tjera të ASK-se.</p> | <p>Statusi: Ka ngritje të kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve profesionale dhe dokumentim të metadatave për disa produkte.</p> <p>Plani: Rritja e dokumentimit të metadatave për produktet statistikore gjatë vitit 2021. Avancimi dhe integrimi i aplikacionit SIMS.</p> |
| 2 Koordinimi i veglave të të diseminimit/ shpërndarjes | <p>Objektivi: Finalizimi i listës së variablave dhe harmonizimi i serive kohore.</p> <p>Përgjegjës: DMTI</p> | <p>Statusi: Në proces të vendosjes së përkufizimeve dhe krijimit të listës së variablave.</p> <p>Plani: Finalizimi i listës së variablave gjatë vitit 2021.</p> |
| 3 Përdorim më i mirë i metodologjive statistikore. | <p>Objektivi: Dokumentimi i të gjitha metodologjive dhe vlerësimet e tyre sipas standardeve të Eurostatit.</p> <p>Përgjegjës: DMTI</p> | <p>Statusi: Ka një progres lidhur me dokumentimin e metodologjisë për disa publikime të vitit 2019.</p> <p>Plani: Gjatë vitit 2020 do të vazhdohet me dokumentimin të proceseve metodologjike për të gjitha produktet e bazuara në mostra.) Vazhdimi i zbatimit të MZHePS (Modeli për gjenerimin/ zhvillimin e proceseve statistikore) (ang.GSPBM).</p> |

5.3. Tabela përmbledhëse në zhvillimin e fushave statistikore në vitin 2021

Për zhvillimin e fushave statistikore, PSZ 2018-2022⁴ për vitin 2021 parasheh këto aktivitete:

| Brenda Kornizës së burimeve ekzistuese | Objektivi dhe përgjegjësia | Statusi 2019/2020 dhe plani 2021 |
|--|--|---|
| 1 BPV (PKSZ) | <p>Objektivi:</p> <p>1. Zbatimi i metodologjisë së ESA 2010, shkurtimi i afatit të publikimit të Llogarive Kombëtare tremujore, rritja e numrit të tabelave me të dhëna për Eurostat, përpilimi i Llogarive Sektoriale, përpilimi i tabelave ofruese përdoruese (SUT), tabelave input output (IOT), përpilimi i Llogarive Regjionale, përpilimi i BPV-së sipas qasjes së të ardhurave.</p> <p>Po ashtu edhe me Llogarit Qeveritare dhe Ekonomis Joformale, zbatimi i metodologjisë ESA 2010 vazhdimi i publikimeve në mujorshë dhe vjetore. Kemi EU/SIDA në mbështetje të ekonomisë.</p> <p>1. Matja e Ekonomisë së Pavrojtuar në ekonomi familjare dhe biznese,</p> <p>Përgjegjës: Departamenti i Llogarive Kombëtare (DLLK).</p> | <p>Statusi:</p> <p>1.1. Mbështetur nga IPA MB 2015 është rritur numri i tabelave të cilat dërgohen në Eurostat, vazhdon përpilimi i Llogarive Sektoriale, përpilimi i tabelave përdoruese dhe ofruese (ang. SUT), përpilimi i Llogarive Regjionale dhe mbledhja e të dhënave për përpilimin e Llogarive Kombëtare me Qasjen e të Ardhurave.</p> <p>Plani:</p> <p>Me përkrahjen e projektit EU/SIDA, të dhënat e Llogarive Kombëtare vjetore dhe tremujore janë në proces të revidimit (përfshirë edhe integrimin e të dhënave nga rezultatet e Anketës për matjen e Ekonomisë së Pavrojtuar)</p> <p>Statusi:</p> <p>Me mbështetjen e Bankës Botërore në vitin 2018 është realizuar Anketa e Ekonomisë së Pavrojtuar në Biznese (për katër aktivitete ekonomike). Me mbështetjen e Projektit të SIDA/BE, rezultatet e kesaj ankete do të perfshihen në të dhënat e Llogarive Kombëtare. Ndërkaq me mbështetjen e Eurostatit vazhdon matja e Ekonomisë së Pavrojtuar edhe në aktivitete të tjera ekonomike, siq është shëndetësia, trafikimi i drogës, etj.</p> <p>Planet për vitin 2021:</p> <p>Zbatimi i mëtejme i ESA 2010, rritja e numrit të tabelave të cilat dërgohen në Eurostat, përpilimi i BPV-së sipas Qasjes së të Ardhurave, shkurtimi i afatit të publikimit të Llogarive Kombëtare tremujore, përpilimi i Llogarive Sektoriale, përpilimi i tabelave përdoruese dhe ofruese (ang. SUT) dhe përpilimi i Llogarive Regjionale. Publikimi i Llogarive Qeveritare sipas metodologjisë së ESA 2010, rritja e numrit të tabelave të cilat dërgohen në Eurostat, shkurtimi i afateve kohore për publikimet e Llogarive Qeveritare, vazhdimi i matjes së Ekonomisë së Pavrojtuar sipas aktiviteteve në bazë të të dhënave në dispozicion dhe integrimi i tyre në të dhënat e Llogarive Kombëtare.</p> |
| 2 Anketa e Fuqisë Punëtore (PKSZ). | <p>Objektivi:</p> <p>2.1. Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së të dhënave të AFP-së në baza tremujore dhe vjetore.</p> <p>Përgjegjës: DSS</p> | <p>Statusi:</p> <p>2.1. Është stabilizuar procesi i publikimeve tremujore dhe vjetore për AFP-në dhe ngritur cilësia e të dhënave duke aplikuar metodën CAPI për mbledhjen e të dhënave.</p> <p>Plani:</p> <p>2.1. Përditësimi i kornizës së mostrës për çdo vit, tre muaj para fillimit të anketës në teren dhe vazhdimi i publikimeve të rezultateve të AFP-së në baza tremujore në përputhje me afatet kohore të BE-së; aplikimi i metodës CATI për ri anketime, publikimi i indikatorëve kryesor të AFP-së në nivel rajonal.</p> |

| | | |
|--|--|--|
| <p>3 Statistikat e Bizneseve (PKSZ)</p> | <p>Objektivi: 1. Rritja e mbulueshmërisë dhe e numrit të publikimeve.</p> <p>Përgjegjës: Departamenti i Statistikave Ekonomike (DSE).</p> | <p>Statusi: 3.1. Gjatë vitit 2019 kemi vazhduar me përmirësimin e Statistikave të PRODCOM-it, Statistikave të Ndërmarrjeve dhe Statistikave të Transportit. Për herë të parë është filluar me dy anketa: Anketa mbi Përdorimin e Teknologjise së Informimit dhe Komunikimit nga bizneset për vitin 2018 dhe rezultatet e anketes janë publikuar në dhjetor 2019 si dhe dhe Anketa e Investimeve në Biznese (Ndërmarrje) rezultatet janë publikuar në shkurt të vitit 2020.</p> <p>Plani: Planet për 2021 janë: Fillimi i mbledhjes së të dhënave me metodën CAPI. Rritja e variablave për statistikave të investimeve, rritja e numrit të publikimeve (statistikave tremujore të shërbimeve).</p> |
| <p>4 Çmimet (PKSZ)</p> | <p>Objektivi: 1. Ngritja e cilësisë për të gjitha indekset e çmimeve.</p> <p>Përgjegjës: DSE</p> | <p>Statusi: 4.1.ASK-ja vazhdon të monitoroj dhe publikoj , Indeksin e Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) në baza mujore dhe vjetore, Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIP), Indeksin e Çmimeve të Prodhimit (IÇP dhe Indeksin e Kostos së Ndërtimit (IKN) në baza tremujore. Në kuader të Programit të Punës në vitin 2020 kemi përfshirë Anketen e Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP - Eng).</p> <p>Plani: Gjatë vitit 2021 planifikohet mbajtja e të gjitha anketave të PFB dhe vazhimi i ngritjes së cilësisë Indeksave të Çimeve përmes shtimit të numrit të vendburimeve, artikujve dhe shërbimeve.</p> |
| <p>5 Tregtia e jashtme (PKSZ)</p> | <p>Objektivi: 1. Vazhdimi i publikimit të STJ në baza mujore dhe vjetore në kohë. 2. Mirëmbajtja e platformës ASK data për qasjen më të lehtë të nga përdoruesit e të dhënave.</p> <p>Përgjegjës: DSE dhe DMTI</p> | <p>Statusi: 5.1.Ka vazhduar publikimi në kohë i STJ në baza mujore dhe vjetore sipas planit. Zbatimi i veglave të PC-Axis për diseminimin interaktiv të të dhënave të Tregtisë së Jashtme është duke u kryer.</p> <p>Plani: Do të vazhdohet me publikimin në kohë për STJ në baza mujore dhe vjetore dhe freskimin në mënyrë të vazhdueshme të platformës PX-Ueb ASK data.</p> |
| <p>6 Anketa e Ekonomive Bujqësore– Anketa e Kulturave Bujqësore, Bimore dhe të Blegtorisë (PKSZ)</p> | <p>Objektivi: 1.Rritja e cilësisë së Statistikave të Bujqësisë dhe shkurtimi kohës së prodhimit të rezultateve. 2.Modernizimi i procesit të mbledhjes të të dhënave.</p> <p>Përgjegjës: DSBM</p> | <p>Statusi: 6.1. Regjistrimi i Bujqësisë 2014 ka siguruar të dhëna kryesore bazë për dizajnimin e mostrës së AEB-së, kjo anketë deri më tash është realizuar 5 herë në baza vjetore. Kjo ka mundësuar përditësimin e kornizës së mostrës dhe dizajnimin e mostrës së AEB-së / Anketën e Kulturave Bujqësore- Bimore dhe të Blegtorisë sipas standardeve ndërkombëtare. Koha e prodhimit është 157 ditë.</p> <p>Plani: Da se koriste administrativni izvori koji su kao Do të shfrytëzohen edhe burimet administrative që janë si potenciale edhe për azhurnimin - freskimin e Regjistrimit Statistikor të Ekonomive Bujqësore si dhe janë potenciale për prodhimin e disa treguesve statistikor bujqësorë. Qëllimi është që të shkurtohet koha e prodhimit në 148 ditë. 6.2. ASK-ja aktualisht bënë grumbullimin e të dhënave për Anketën e Ekonomive Bujqësore në metodën tradicionale. Plani: Ask-ja planifikon Modernizimi i procesit të grumbullimit të dhënave kalimi nga metoda "PAPI" ne metodën elektornike "CAPI".</p> |

| | | |
|--|--|--|
| 7 Statistikat e tjera Sociale (PKSZ). | <p>Objektivi: Rritja e numrit të treguesve të publikuar për Statistika të tjera Sociale si: Arsim, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale sipas kërkesave të përdoruesve, përmirësimi i cilësisë së të dhënave si shkurtrimi i kohës së publikimeve si dhe implementimi i ISCED 2011.</p> | <p>Statusi: 7.1.Ka vazhduar publikimi i të dhënave të Mirëqenies Sociale në baza tremujore.</p> |
| | <p>Përgjegjës: DSS</p> | <p>Plani: Në bashkëpunim me Institucionet që janë burime administrative të këtyre të dhënave synohet që gjatë vitit 2021 të rritet cilësia e këtyre statistikave.</p> |
| 8 Statistikat e Lindjeve, Vdekjeve, Kurorëzimeve dhe Shkurorëzimeve (PKSZ) | <p>Objektivi: Statistikat vitale (Lindjet, Vdekjet) harmonizimi i një pyetësi të vetëm në nivel vendi për grumbullimin e të dhënave vitale (Lindje dhe Vdekje)</p> | <p>Statusi: 8.1.Ka vazhduar publikimi në kohë i Statistikave të lindjeve, vdekjeve, kurorëzimeve dhe shkurorëzimeve sipas planit.</p> |
| | <p>Përgjegjës: DSS.</p> | <p>Plan: Në bashkëpunim me institucionet që janë burime administrative të këtyre të dhënave synohet që gjatë vitit 2020 të rritet cilësia e këtyre statistikave si dhe harmonizimi i pyetësorit me standardet ndërkombëtare.</p> |
| 9 Vlerësimi i Popullsisë në baza vjetore (PKSZ). | <p>Objektivi: 1.Vlerësimi i Popullsisë në baza vjetore dhe rritja e treguesve lidhur me Vlerësimin e Popullsisë.</p> | <p>Statusi: 9.1. Vlerësimi i fundit i Popullsisë është bërë për vitin 2018 dhe gjatë vitit 2020 është në proces Vlerësimi i Popullsisë për vitin 2019.</p> |
| | <p>Përgjegjës: DSS.</p> | <p>Plani: Gjatë vitit 2021 do të bëhet Vlerësimi i Popullsisë për vitin 2020.</p> |
| 10 Të dhënat administrative (PKSZ). | <p>Objektivi: 1. Identifikimi dhe avancimi i burimeve të të dhënave administrative dhe pranimi i tyre në formë elektronike.</p> | <p>Statusi: 10.1.Lista e Institucioneve për furnizim me të dhëna administrative ekziston. Janë nënshkruar shumë Marrëveshje të Mirëkuptimit (MeM) me Institucionet e Kosovës. Në MeM janë vendosur rregullat e dërgimit të të dhënave. Ka vazhduar marrja e të dhënave administrative nga Institucionet e ndryshme: MPMS, MAP, Këshilli Gjyqësor i Pavarur i Kosovës, MBPZHR, MMPH, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, ATK, Dogana e Kosovës, ARBK, Thesari, Trusti Pensional, etj.</p> |
| | <p>Përgjegjës: Të gjitha departamentet prodhuese dhe mbështetëse</p> | <p>Plani: Të nënshkruhen MeM me Ministrinë e Drejtësisë (MD), si dhe do të bëhet freskimi i disa MeM-ve të mëparshme. Vazhdimi i digjitalizimit të procesit të marrjes së të dhënave administrative.</p> |

| Jashtë kornizës së burimeve ekzistuese | Objektivi dhe përgjegjësia | Statusi 2018/2019 dhe plani 2020 |
|---|---|--|
| 1 Regjistri Statistikor i Fermave (PKSZ). | <p>Objektivi: 1.1. Përditësimi-azhurnimi i Regjistrit Statistikor të Fermave.</p> <p>Përgjegjës: DSBM</p> | <p>Statusi: 1.1 Është krijuar Regjistri i Ekonomive Bujqësore nga të dhënat e Regjistrimit të Bujqësisë 2014. Gjithashtu deri me tani janë realizuar 5 anketa vjetore të AEB-së.</p> <p>Plani: Gjatë vitit 2020 do të bëhet freskimi- përditësimi Regjistrin të Ekonomive Bujqësore nga burimet administrative dhe nga AEB 2019 dhe 2020. Ky regjistër do të përdoret për anketa të ardhshme të bujqësisë.</p> |
| 2 Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (SILC) (PKSZ) | <p>Objektivi: Shkurtimi i afateve kohore të publikimit dhe ngritja e kapaciteteve profesionale për SILC.</p> <p>Përgjegjës: DSS</p> | <p>Statusi: 2.1. Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (SILC) financiar nga Banka Botërore për herë të parë si anketë e plotë është zhvilluar në vitin 2018. Gjatë vitit 2019 është punuar në përgatitjen e rezultateve të cilat priten të publikohen në pjesën e parë të vitit 2020. Janë duke u bërë përgatitjet e nevojshme për zhvillimin e anketës së radhës SILC 2019, e cila do të financohet nga buxheti i ASK-së.</p> <p>Plani: Ngritja e kapaciteteve profesionale për Anketën e SILC-ut.</p> |
| 3 Anketa mbi përdorimin e Teknologjisë Informative dhe të komunikimit (TIK) | <p>Objektivi: Shkurtimi i afateve kohore të publikimit të TIK.</p> <p>Përgjegjës: DSS</p> | <p>Statusi: 3.1. Janë duke u bërë përgatitjet e nevojshme për zhvillimin e anketës TIK 2019 në terren. Anketa do të zhvillohet gjatë muajve prill dhe maj 2020 përmes metodës CAPI (tableta).</p> <p>Plani: Do të vazhdoj zhvillimi i anketës së rregullt çdo vit dhe implementimi i metodës CAPI për grumbullimin e të dhënave të TIK si dhe shkurtimi i vazhdueshëm i afateve kohore për publikimin e të dhënave.</p> |

5.4. Përpunimi i Statistikave të Veçanta

ASK-ja sipas përgjegjësisë ligjore që ka, bënë edhe përpunimin e Statistikave të Veçanta Zyrtare.

Në vitin 2021 do të vazhdohet me pilot projektet e IPA 2017 për periudhën 2020-2021. Gjatë kësaj periudhe janë planifikuar Pilot Projektet e Paritetit të Fuqisë Blerëse, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit, Statistikat Afatshkurta të Biznesit, Regjistri Statistikor të Bizneseve, Statistikat e Transportit, Statistikat mbi Shfrytëzimin e TIK në Biznese, Statistikat e Energjisë, Statistikat e Turizmit, Statistikat e Tregtisë së Jashtme mbi mallrat dhe implementimi i rregullores së FRIBS (Framework Regulation Integrating Business Statistics - Rregullorja Kornizë që Integron Statistikat e Biznesit).

Në kuadër të Llogarive Kombëtare do të vazhdohet me pilot projektet: Metodologjia e Llogarive Kombëtare, Llogaritë Kombëtare (Programi i Transmisionit, ANA, QNA, Raportimi i Cilësisë), Llogaritë Kombëtare Rajonale, Llogaritë Kombëtare Sektoriale, Llogaritë Kombëtare (SUT/ IOT), Statistikat e Financave Qeveritare, si dhe Procedura e Mosbalancimit Makroekonomik.

Tek Statistikat Sociale projekti MICS6 është në proces të implementimit dhe do të vazhdohet edhe gjatë vitit 2020, pastaj Statistikat mbi Shfrytëzimin e TIK në Biznese, SILC, AFP, shpërndarjes dhe mbështetjes ndaj përdoruesve nga Eurostatit,

Ndërsa në kuadër të Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit janë planifikuar pilot projektet për Statistikat e Bujqësisë (Statistikat vjetore të Kulturave Bujqësore Bimore, Statistikat e Pemëtarisë, Statistikat e Prodhimtarisë Blegtorale, Anketa Strukturore e Fermave, Statistikat Agromonetare) dhe Llogaritë Ekonomike Mjedisore.

Këto aktivitete nuk janë pjesë e Programit Kryesor të Statistikave Zyrtare. ASK-ja do t'i shfrytëzojë këto mundësi për t'i fuqizuar statistikat zyrtare me tregues dhe ngritje të kapaciteteve, duke u mbështetur tek donatorët e ndryshëm, kryesisht Eurostat-i. Këto aktivitete zhvillohen në kuadër të periudhës kohore sipas marrëveshjes në mes të ASK-së, Eurostatit, UNICEF-it apo donatorëve të tjerë.

Financimi i këtyre projekteve bëhet nga donatorët potencialë. Bazuar në këtë mbështetje ASK-ja planifikon, organizon dhe zhvillon procesin e punës brenda Institucionit dhe angazhohet për burime shtesë të të dhënave sipas mundësisë dhe legjislacionit në fuqi.

ASK-ja që nga fundi i vitit 2015 është në pritje të aprovimit të Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 (plotësim - ndryshim) nga Qeveria e Kosovës, që ofron bazë ligjore të realizimit të këtyre statistikave në përputhje me Ligjin në fuqi.

6. BUXHETI DHE PASQYRAT E PRODHIMIT

Planifikimi i buxhetit në kuadër të Planit të përgjithshëm, fillon me një konsultim të brendshëm në bazë të nevojave të departamenteve prodhuese në procesin e zbatimit të Planit Vjetor të Punës. Në këtë drejtim, për vitin 2021, për t'i përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë, e posaçërisht për t'i shtuar aktivitetet e tjera, Departamenti i Administratës merr informata nga të gjitha departamentet e ASK-së për qarkoren buxhetore të Planit Vjetor të Statistikave Zyrtare 2021, në mënyrë që të sigurohen të dhënat e mjaftueshme, lidhur me planifikimin e vitit vijues. Sipas plotësimit të kërkesave të departamenteve të ASK-së, për përgatitjen e propozim-buxhetit, dokumenti përmban planet afatshkurtra dhe afatmesme dhe një deklaratë mbi synimet dhe prioritetet, që ASK-ja ka për një planifikim të mirëfilltë të buxhetit për vitin 2021.

Për aktivitetet e vitit 2021, me qëllim të realizimit të anketave, ASK-së i nevojitet rritje e buxhetit në kategorinë “Mallra dhe Shërbime”, për Projektin e Regjistrimit të Popullsisë nevojitet buxhet prej 6,622,098.00 Euro. Mjete shtesë janë paraparë për Statistikat Ekonomike, Tregun e Punës, Statistikat e Varfërisë, Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit. Në kategorinë “Paga dhe Mëditje” nevojiten rritje të kapaciteteve njerëzore për 25 pozita të reja, përafërsisht me një kosto shtesë prej 145,608.00 EUR.

Tabela 4. Buxheti i ASK-së për vitin 2020 dhe planifikimi për vitin 2021

| Vitet | 2020 | 2021 |
|---------------------|---------------------|---------------------|
| Kategoritë | Aktuale | Të nevojshme |
| Stafi | 166 | 191 |
| Paga dhe Mëditje | 1,094,936.85 | 1,240,544.85 |
| Mallra dhe Shërbime | 2,632,318.00 | 8,024,712.00 |
| Shpenzime Komunale | 21,875.00 | 21,875.00 |
| Gjithsej | 3,749,129.85 | 9,287,131.85 |

Për aktivitetet e rregullta të ASK-së dhe aktivitetet tjera shtesë të departameteve prodhuese, në kategorinë mallra dhe shërbime për vitin 2021 janë 1,402,614.00 Euro, ndërsa 6,622,098.00 Euro janë planifikuar për Projektin e Regjistrimit të Popullsisë 2021.

6.1. Pasqyra e prodhimit

Planifikimi i mbështetur në rezultate do të vazhdojë të aplikohet edhe gjatë viteve në vijim, bazuar në performancën e vitit të kaluar, analizës së tanishme dhe planifikimit në të ardhmen. Përveç ndikimit në vetë procesin e planifikimit, pasqyrat e prodhimit kanë për qëllim të mbajnë të informuar edhe partnerët e jashtëm për rezultatet e pritshme të prodhimit, strukturën në absorbimin më të madh të kapaciteteve në tërë procesin prodhues, resurset e nevojshme, etj. Për vitin 2021, synimi është rritja e prodhimit në shkallën prej 4% në krahasim me vitin paraprak. Në Programin e Statistikave Zyrtare 2018-2022, objektivat janë për 20% rritje të prodhimit deri në fund të vitit 2022.

Në tabelat vijuese janë listuar prodhimet statistikore dhe angazhimet kryesore të njëjësive mbështetëse ASK-së për prodhimet e statistikave zyrtare.

STATISTIKAT E LLOGARIVE KOMBËTARE

| Programet | Departamenti | Prodhimet dhe shërbimet statistikore | Shpeshësia e publikimit | Partnerët nga jashtë | Koha e prodhimit 2018-plan | Koha e prodhimit 2019-plan | Koha e prodhimit 2020-plan | Koha e prodhimit 2021-plan | BNJ (njerëz-ditë) 2018 plan | BNJ (njerëz-ditë) 2019 plan | BNJ (njerëz-ditë) 2020 plan | BNJ (njerëz-ditë) 2021 plan |
|-----------|--------------|---|-------------------------|----------------------|----------------------------|----------------------------|----------------------------|----------------------------|-----------------------------|-----------------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| PKSZ | DLLK | BPV me Qasjen e Shpenzimeve | vjetore | IPA NACIONAL | 263 | 262 | 262 | 260 | 57 | 57 | 53 | 51 |
| PKSZ | DLLK | BPV me Qasjen e Prodhimit | vjetore | IPA NACIONAL | 263 | 262 | 262 | 260 | 57 | 57 | 53 | 51 |
| PKSZ | DLLK | BPV sipas Qasjes së Shpenzimeve dhe Prodhimit (tremujore) (TM4 2019-TM3 2020) | tremujore | IPA NACIONAL | 362 | 361 | 355 | 350 | 1172 | 1172 | 1132 | 1121 |
| PKSZ | DLLK | SUT | vjetore | IPA NACIONAL | | | | | | | | 364 |
| PKSZ | DLLK | Gjithsej: | | | 888 | 885 | 879 | 870 | 1286 | 1286 | 1238 | 1587 |

STATISTIKAT EKONOMIKE

| Programet | Departamenti | Prodhimet dhe shërbimet statistikore | Shpeshësia e publikimit | Partnerët nga jashtë | Koha e prodhimit 2018-plan | Koha e prodhimit 2019-plan | Koha e prodhimit 2020-plan | Koha e prodhimit 2021-plan | BNJ (njerëz-ditë) 2018 plan | BNJ (njerëz-ditë) 2019 plan | BNJ (njerëz-ditë) 2020 plan | BNJ (njerëz-ditë) 2021 plan |
|-----------|--------------|---|-------------------------|----------------------|----------------------------|----------------------------|----------------------------|----------------------------|-----------------------------|-----------------------------|-----------------------------|-----------------------------|
| PKSZ | DSE | Anketa Strukturore e Biznesit ASN:4000 ndërmarrje | vjetore | IPA NACIONAL | 338 | 338 | 336 | 334 | 265 | 264 | 256 | 250 |
| PKSZ | DSE | IÇIMP (TM4 2020-TM3 2021) 150 ndërmarrje | TM | Nuk ka | 264 | 264 | 256 | 255 | 234 | 234 | 224 | 223 |
| PKSZ | DSE | Indeksi i Çmimeve të Prodhimit IÇP (TM4 2020-TM3 2021) 200 ndërmarrje | TM | Nuk ka | 270 | 270 | 264 | 261 | 234 | 234 | 226 | 225 |
| PKSZ | DSE | Stat. Afatshkurtra në Industri (TM4 2020-TM3 2021) 200 ndërmarrje | TM | IPA NACIONAL | 318 | 314 | 314 | 298 | 169 | 169 | 169 | 169 |
| PKSZ | DSE | Stat. Afatshkurtra në Ndërtimtari | nuk ka | IPA NACIONAL | 0 | 0 | 0 | 0 | 28 | 28 | 28 | 28 |
| PKSZ | DSE | Stat. Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë (TM4 2020-TM3 2021) 600 ndërmarrje | TM | IPA NACIONAL | 322 | 317 | 308 | 302 | 171 | 171 | 167 | 156 |
| PKSZ | DSE | Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet në Kosovë (TM4 2020-TM3 2021) | TM | IPA NACIONAL | 121 | 121 | 121 | 118 | 16 | 16 | 16 | 16 |
| PKSZ | DSE | Freskimi i Regjistrimit Statistikor të Bizneseve, 6 000 ndërmarrje | nuk ka | Nuk ka | 0 | 0 | 0 | 0 | 148 | 148 | 138 | 136 |
| PKSZ | DSE | Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit | Mujore | IPA MB 2018 & 2019 | 139 | 137 | 133 | 132 | 281 | 281 | 281 | 277 |
| PKSZ | DSE | Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit | vjetore | IPA MB 2018 & 2019 | 152 | 151 | 150 | 148 | 46 | 46 | 46 | 38 |
| PKSZ | DSE | Statistikat mbi Tregtinë e Jashtme | Mujore | IPA MB 2018 & 2019 | 287 | 284 | 278 | 277 | 237 | 237 | 225 | 219 |
